

DI
DRITA ISLAME

Me sy të përbotur
të lutemi!



Revista Drita Islame në versionin online...

www.dritaislame.al



TEOLOGJI

BOTA JONË

REFLEKSIONE

TRASHËGIMI KULTURORE

FAMILJA

PERSONALITETE



www.dritaislame.al

“Drita islame”
Botim i Komunitetit Mysliman
të Shqipërisë

DREJTOR
Dorian Demetja

KRYEREDAKTOR
Mehmet Disha

DIZAJNI DHE FAQOSJA
Erzen Carja

KONTAKT:
Tel/fax 04 223 04 092
E-mail: info@dritaislame.al

Viti XXXIII i botimit
Nr. 02 (489)
Shkurt, 2024

ISSN 2226-7115



Artikujt
që vijnë në redaksi
dhe botohen,

nuk paraqesin domosdoshmërisht
edhe pikëpamjet e revistës.

Materialet e sjella në redaksi,
pavarësisht nëse botohen apo jo,
nuk i kthehen autorit.

PËRMBAJTJA

4 Në pritje të muajit të Ramazanit / Mehmet Disha

6 A vijnë përsëri ditët e bukura? / Sümeyra Koç

8 Lajme / Aktivitete



12 Me sy të përlotur të lutemi / Dorian Demetja

14 Medreseja e tiranës - Një shekull për arsimin e diturinë / Xhemal Balla

18 Profeti ynë (a.s.) është profeti i mëshirës / Fatma Karaj

20 Nata e mirë e Israsë dhe Miraxhit / Redaksia

22 Udhëzimi i Profetit a.s. në bashkëjetesë me të tjerët / Prof. dr. Ali Xhum'a

26 Vlera e muajit Shaban dhe Nata e Beraetit / Eduard Shekriu

28 Historia se si u bë mysliman Amr Bin Asi / M. Jusuf Kandeheui




30 Të rinjt e sotshëm si mejtojnë edhe kujt i mbesojnë / Ferit Vokopola

32 Faik Kasollja (1930-2019) / Personalitet

34 Si të qëndrojmë larg gjynaheve (sedd-i dherrai) / Leonard Çela

36 Ndikimi i abdesit në meridianet e energjisë së njeriut / Ali F. Iljaz

38 Për ty Allahu mjafton / Arjola Zaçi



NË PRITJE të muajit TË RAMAZANIT



Myslimanët e presin Ramazanin me përmallim dhe gëzim duke kërkuar afërsinë e Zotit, mbështetur te mëshira e Tij në këtë muaj. Është sikur, pas lodhjes së gjatë në muajt e tjerë të vitit, Ramazani është streha e pushimit për zemrën. E si të mos gëzohen ata që e dinë se Ramazani është mëshirë nga Allahu për robtë e Tij, mirësi të cilën e përcakton vetëm Ai. Këtë nuk e kuptojnë veç të zotët e mendjes. Përse të mos hapen gjokset në Ramazan, kur ai për të varfrit është moment kënaqësie, për udhëtarët lehtësim, për të sëmurët shërim, për mëkatarët pendim dhe për të udhëzuarit, forcim dhe shtim i besimit.

E si të mos hapen kraharorët me ardhjen e muajit të mirësive, të fitoreve, të leximit të Kur'anit dhe shtimit të bami-rësisë...

E si jo, kur ditët janë të gjallëruara, shtëpitë parfumosen me leximin e Kur'anit, toka pastrohet me djersët dhe lotët e rukuve e të sexhdeve...

Në çdo natë, qielli përqafton duatë që dërgojnë krijesat për te Krijuesi i tyre, pra ringjallen zemrat pas "vdekjes" së tyre dhe trupi shërohet nga sëmundjet e tij.

E si të mos hapen kraharorët e besimtarëve në Ramazan, ku për çdo natë lirohen shpirtrat që meritojnë hyrjen në zjarr, hapen dyert e Xheneteve dhe shtohen radhët e atyre që hyjnë në Rejan (emri i portës së Xhenetit në të cilën hyjnë vetëm agjëruesit)...

Përse të mos përkushtohen të mençurit me agjërim, kur Allahu i Lartësuar thotë në një hadith kudsij: "Çdo punë e birit të Ademit është për të, përveç agjërimit, i cili është për Mua dhe Unë di si shpërblej për të. Era e gojës së agjëruesit është më e mirë tek Allahu se aroma e miskut."

A nuk është i nevojshëm agjërimi ditën kur do të vendoset peshorja dhe kur llogaria do të jetë për çdo gjë?! Ruajeni pra veten nga gabimet dhe mangësitë.

O robtë e Allahut, dijeni se në agjërim shfaqet forca e besimit dhe vendosmëria në adhurim. Në agjërim shpirtrat e besimtarëve manifestojnë nënshtrim ndaj urdhrave të Allahut. Duke u larguar nga dëfrimet dhe pasionet, agjëruesit lënë mënjanë dëshirat për premtimin e Xhenetit, që nuk e kanë parë.

Si të mos gëzojmë për muajin e Ramazanit kur në të na jepet mirësia e shefatit. Ditën që nuk bën dobi askush për asgjë: "Atë ditë nuk bën dobi ndërmjetësimi (shefati), përveç atij, të cilin e ka lejuar i Gjithëmëshirshmi të ndërmjetësojë dhe për të cilin e pëlqeu ndërmjetësimin."

Në Ramazan shtohet leximi i Kur'anit, për të cilin Profeti a.s. ka thënë: "Agjërimi dhe Kur'ani ndërmjetësojnë (për robin) Ditën e Kiametit. Agjërimi thotë: O Allah. Unë e privova nga ushqimi, prandaj lejoni më të ndërmjetësoj për të. Ndërsa Kur'ani thotë: O Allah. Unë e privova nga gjumi, prandaj lejoni më të ndërmjetësoj për të, dhe të dyve iu pranohet shefati."

E si mos të gëzohen agjëruesit në Ramazan kur dyert e qiellit hapen për ata që luten dhe Allahu ua pranon lutjet...

Allahu i Lartë thotë pas ajeteve të agjërimit: "**Kur**

të pyesin robtë e Mi për Mua, Unë jam pranë tyre, i përgjigjem lutjes së thirrësit kur ai më lutet, pra le të më përgjigjen Mua dhe të më besojnë, me qëllim që të jenë të udhëzuar." (Bekare, 186)

E si të mos gëzohen mysli-manët me muajin e Ramazanit kur ai është shkak për faljen e mëkateve...

Profeti a.s. thotë: "Kush e agjëron Ramazanin me besim dhe bindje (në arritjen e shpërblimit), i falen të gjitha gjynahet e kaluara."

O bashkësi e Kur'anit. Mirësitë e muajit të Ramazanit janë të shumta sa që nuk mund t'i përmendim këtu, por do mjaftohemi vetëm me disa prej tyre:

Qëllimi i vërtetë është ruajtja e dy gjërave të rëndësishme, për të cilat ka këshilluar Sheriati i ndritur; së pari: Imani-besimi dhe llogaritja e shpërblimit: "Kush falet Natën e Kadrit me besim dhe duke llogaritur shpërblimin (me sinqeritet), i falen të gjitha mëkatet e kaluara; dhe kush agjëron muajin e Ramazanit me besim dhe duke llogaritur shpërblimin, i falen të gjitha mëkatet e kaluara."

Dijetarët kanë thënë: Nijeti është kusht që punët të bëhen për afrim tek Allahu. Qëllimi për besimin është besimi se me të vërtetë agjërimi është detyrim. Kurse fjala ihtisab, do të thotë pritje e shpërblimit vetëm prej Allahut të Lartë.

Së dyti, ruajtja e agjërimit. Kjo arrihet duke qëndruar larg nga gënjeshtria dhe veprat e pahijshme. Profeti a.s. ka thënë: "Kush nuk e lë gënjeshtren dhe të punuarit me të, Allahu s'ka nevojë që të lërë të ngrënit dhe të pirit."

Largimi nga gënjeshtria është edukim që plotëson agjërimin. Si mund ta mendojë dikush veten e tij agjërueshëm kur nuk largohet nga gënjeshtria dhe të punuarit me të?!

Bejdaviu ka thënë: "Sheriati nëpërmjet agjërimit nuk ka si qëllim privimin e njeriut me uri dhe etje, por është një adhurim që thyen epshin, duke nënshtruar veten për të mbrojtur shpirtin e bindur. Nëse nuk ndodh kjo, Allahu nuk e shikon atë adhurim me shikim pranimit. Agjëruesi i sinqertë agjëron me gjuhën e tij nga gënjeshtria, përgojimi dhe thashethemet, nga fjala dhe dëshmia e rrejshme. Agjëron të dëgjuarit e tij nga dëgjimi haram. Syri i tij agjëron nga shikimi i haramit. Agjëruesi i sinqertë nuk e lidh zemrën e tij me mëkate, gabime, mashtrime dhe urrejtje për mysli-manët. Ai nuk bën padrejtësi dhe as nuk i përbuz të tjerët. Kush nuk i kupton ashtu siç duhet këto dobi të mëdha të agjërimit dhe faljen gjatë tij, atëherë ai do të jetë ashtu siç e përshkruan i Dërguari i Allahut a.s.: "Ndoshta agjëruesi nuk përfiton nga agjërimi i tij asgjë tjetër veç urisë dhe etjes; ndoshta ai që falet (natën gjatë Ramazanit), nuk përfiton veç qëndrimin e tij pa gjumë."

"Thuaj: Vetëm mirësisë së Allahut dhe mëshirës së Tij le t'i gëzohen, se është shumë më e dobishme se ajo që grumbullojnë." (Junus, 58)

Mehmet Disha

A vijnë përsëri ditët e bukura?



"A do të vijmë sërish ditë të mira?" pyesim ne ndërsa kalojmë ditët e trazuar. Në fakt, ditët që duken të këqija në fakt çojnë në bukuri përtej asaj që prisnim, por njeriu e ka të vështirë të shohë se çfarë bukurish janë ato momente me telashe.

Si dikush që u rrit në një shtëpi ku koha e leximit familjar ishte e zakonshme kur isha e vogël, mund të them se informacioni i lexuar me mendje të kthjellët ka një vend të veçantë në kujtimet tona. Një ditë, teksa lexoja për "durimin" si familje, dëgjova nga babai im shprehjen "durim aktiv". Ngaqë isha e vogël në atë kohë, nuk e kuptoja plotësisht.

Rezulton se durim aktiv do të thotë të përpiqemi të bëjmë më të mirën që mundemi edhe kur duart tona janë të lidhura. Unë vetë isha në atë situatë për një kohë. Në 'medresenë jusufije'¹, unë rashë nën drejtimin e urtë të fatit.

Në atë kohë kur fatkeqësitë po na binin, fillova të mendoj me vete. Pyes veten se cila ishte urtësia në këto telashe? Kuptova që të rrih kot nuk do të thotë të jesh i duruar dhe e përjetova deri në thelb kuptimin e shprehjes "durim aktiv".

Kisha shumë kohë për të bërë vetë-reflektim në 'medresenë jusufije'. Në të njëjtën kohë, kuptova atje se durimi joaktiv mund ta çojë një person në depresion. Aty përsëri pashë shejtanin që po afrohej nga e djathta dhe po përpiqej të na tërhiqte në "vorbullën e krizave" dhe përjetova frikën e "humbjes në zonën e fitimit".

Ndërsa isha në këto ndjenja, ndesha në kuptimin e ajetit të mëposhtëm:

"Apo ishit ju udhëheqësit e kombeve të mëparshme? E kishit menduar se do të hynit në xhenet pa u ekspozuar ndaj situatave që ju kanë ndodhur? Ata iu nënshtruan vështirësive të tilla dërmuese, vështirësish të tilla dhe u tronditën aq dhunshëm sa që edhe Profeti dhe besimtarët me të pyetën: "Kur do të arrijë ndihma e premtuar nga Allahu?" Ata arritën në pikën për të thënë: Dijeni mirë se ndihma e Allahut është afër." (Bekare, 2/214).

Kjo situatë ishte një provë për të gjithë ne. "Bëmë atë që duhej të bënim". Nuk u ulem mënjandë. Ajo periudhë ishte 1. Një emër simbolik për burgun në Egjipt ku e kishin hedhur pejgamberin Jusuf (a.s) (Shënim i perkthyesit).

një periudhë e dhënies së drejtësisë për gjithçka që thamë. Prandaj ku jemi ishte detyra jonë ta bënim atë më të përshtatshmen për ne.

Ne u përpoqëm t'i falnim namazet tona me kujdes dhe përpikëri dhe përpiqeshim të përmirësojmë veten sa herë që kishim kohë. Aty mësova të luaja shah dhe merresha me qëndisje të ndryshme me dorë. Ata që dinin anglisht u jepnin mësimet atyre që nuk dinin anglisht. Agjërimi, namazet e teravive dhe tehexhudit gjatë muajit të Ramazanit kryheshin me një gëzim tjetër takvallaku.

Mbrëmjeve luanim volejball në kopsht dhe pas darkës pinim çaj dhe bisedonim së bashku. Ne merrnim libra nga biblioteka, po i lexonim ato në mënyrë të ndërsjellë.

Një ditë, një roje solli librat që porositëm dhe tha: "Para jush, biblioteka nuk u hap kurrë, fillimisht i pastrojmë librat, pastaj ju sjellim, ju na keni dhënë punë shtesë". U habitëm mjaft dhe thamë: "Si, si?".

Sa e rëndësishme është të heqim qafe mendimet negative me durim aktiv në periudha të tilla, në vend që të dëgjojmë pëshpëritjet e shejtanit dhe të tërhiqemi në depresion.

Mund të them se mësova rëndësinë e të paturit një perspektivë pozitive gjatë atyre kohërave të vështira. Po ngushëllohesha duke menduar për urtësinë e fatit.

Më vonë, procesi i testimi u lehtësua pak për mua dhe familjen time. Qëndrimi atje për një periudhë kohore më hapi dyert e jashtëm, si shumica e vëllezërve/motrave tona. Në fund, pashë se ato ditë ishin vetëm ditë të këqija në dukje, por brenda saj fshiheshin shumë bukuri. Si fara të hedhura në tokë, ato lulëzuan dhe u rritën ndërsa ne i ujtnim me durim dhe shpresë.

Kisha kaluar një proces të vështirë, por falë mendimit pozitiv, durimit aktiv dhe lutjeve, gjithçka doli shumë mirë, falë Zotit një mijë herë. Zoti fsheh bukuri të paimagjinueshme në problemet aktuale të të gjithëve dhe bekime në zemrat e vëllezërve dhe motrave tona që po përpiqen t'u bëjnë ballë vështirësive në këtë rrugë.

Përktheu: Haki Sahitaj



1

**KRYETARI I KMSH, H. BUJAR SPAHIU VIZITË NË
XHIDE TË ARABISË SAUDITE**

Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiu, me ftesë të ministrit të Haxhit dhe Umres, z. Taufik bin Feuzan al-Rabiah, zhvilloi një vizitë disa ditore në Xhide të Arabisë Saudite.

Kryetari i KMSH-së e falenderoi ministrin për punën e palodhur në shërbim të besimtarëve që vizitojnë Arabinë Saudite për kryerjen e Haxhit dhe Umres.

Ministri Al-Rabiah shprehu konsideratën e tij për Komunitetin Mysliman të Shqipërisë për bashkëpunim e frytshëm mes dy institucioneve në organizimin e Haxhit.

Pas takimit, kryetari i KMSH-së dhe Ministri i Haxhit dhe Umres nënshkruan marrëveshjen e Haxhit ndërmjet dy vendeve për Haxhin e vitit 2024.

Në kuadër të bashkëpunimit mes dy institucioneve, ministri i Haxhit dhe Umres me ftesë të Komunitetit Mysliman të Shqipërisë do të vizitojë Shqipërinë gjatë këtij viti, ku do të marrë pjesë në konferencën dhe panairin e Haxhit dhe Umres për rajonin, aktivitetet ky që do të bashkë-organizohet nga dy institucionet e lartpërmendura.

Gjatë kësaj vizite Kryetari i KMSH-së shoqërohet nga Myftiu i Tiranës dhe përgjegjësi i Zyrës së Haxhit, z. Lauren Luli dhe drejtori i Kabinetit, z. Ejup Lila.

Gjithashtu, delegacioni i KMSH mori pjesë në Konferencën dhe Panairin për shërbimet e Haxhit dhe të Umres. Në këtë konferencë morën pjesë ministra, kryetarë bashkësish islame si dhe përgjegjës të zyrave të haxhit nga më shumë se 80 shtete të botës. Organizimi në fjalë përbëhet nga konferenca, panairi i firmave që ofrojnë shërbimet e haxhit dhe umres si dhe workshope me koordinatorët e haxhit për çdo vend pjesëmarrës.





2

**KREU I MISIONIT DIPLOMATIK ALGJERIAN NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË
VIZITË NË SELINË E INSTITUCIONIT**

Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiu, priti në selinë e institucionit në një takim kortezie, Kreun e Misionit Diplomatik Algjerian në Republikën e Shqipërisë, z. Abduluehab Saidani.

Në fjalën e tij, kryetari Spahiu, i uroi atij mirëseardhjen dhe e njohu atë shkurtimisht me institucionin të cilin ai drejton, duke theksuar këtu edhe rolin që KMSH luan si faktor në shoqërinë tonë.

Ndërsa z. Saidani, prezantoi misionin e tij diplomatik dhe shprehu gatishmërinë për hedhjen e bazave për ndërtimin dhe zhvillimin e marrëdhënieve ndërinstitucionale të KMSH-së me institucionet simotra në republikën e Algjerisë.

Në këtë kontekst, u ra dakord parimisht për firmosjen e një memorandumi bashkëpunimi me Ministrinë e Çështjeve Fetare Algjeriane. Si hap i parë në këtë drejtim, Komuniteti Mysliman i Shqipërisë, do të dërgojë një hafiz në konkursin ndërkombëtar të Kuranit që do të zhvilloj ministria në fjalë gjatë muajve në vijim.

Gjatë këtij takimi, Kryetari Spahiu shoqërohej nga Përgjegjësi i Zyrës me Botën Arabe në KMSH, z. Ermir Gjana dhe Drejtori i Kabinetit, z. Ejup Lila.





3

INAUGUROHET PROJEKTI: "NË NDIHMË TË FËMIJËVE JETIMË TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË"

U zhvillua në ambientet e Medresesë Tiranë, ceremonia e inaugurimit të projektit: "Në ndihmë të fëmijëve jetimë të Republikës së Shqipërisë", projekt ky i financuar nga Qendra Bamirëse "Mbreti Selman" dhe i aplikuar në vendin tonë nga Komuniteti Mysliman i Shqipërisë me koordinim të Ambasadës së Mbretërisë së Arabisë Saudite në Tiranë.

Të pranishëm në këtë ceremoni ishin: Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiu, Ambasadori i Mbretërisë së Arabisë Saudite, z. Fajsal Gazi Hifdhi, myftinj të rretheve të ndryshme në të cilët shtrihet ky projekt si dhe familjarë e fëmijë jetim që kanë përfutur prej tij.

Në fjalën e tij përshëndetëse, kryetari Spahiu, shprehu kënaqësinë e tij në jetësimin e këtij projekti kaq domethënës në bashkëpunim me qendrën "Mbreti Selman", qendër e cila sipas tij synon të sjellë gëzim jo vetëm tek fëmijët jetimë që do të përfitojnë nga projekti në fjalë, por nga të gjithë njerëzit kudo në botë që përfitojnë nga projekte të ngjashme.

Më tej, të pranishmit i përshëndeti gjithashtu edhe ambasadori Hifdhi, i cili u shpreh se këto ndihma janë pasqyrim i vizionit të Mbretit të Mbretërisë së Arabisë Saudite, mbretit Selman, të cilët zgjasin dorën e ndihmës kudo ku është nevoja në të gjithë botën.

Fjalë të rastit, ku trajtuan ecurinë e deritanishme të këtij projekti dhe problematikën apo nevojat e përgjithshme lidhur me këta fëmijë, mbajtën gjithashtu edhe Myftiu i Tiranës, Lauren Luli, Myftiu i Lushnjës, Gramos Blliku dhe Myftiu i Korçës, Ledian Cikallesi.

Në fund të ceremonisë u shpërndanë në mënyrë simbolike disa zarfe me mbështetjen financiare të muajit Janar.

Ky projekt, përveç mbështetjes financiare mujore për këta 206 jetimë për të gjithë vitin në vazhdim, përfshin edhe kurset edukative me fëmijët, kurse të cilat kanë vazhduar dhe zhvillohen çdo javë nën kujdesin e Myftinive ku shtrihet projekti.





4

NËNSHKRUHET MARRËVESHJA E BASHKËPUNIMIT NDËRMJET ZYRËS RAJONALE TË LIGËS SË BOTËS ISLAME NË BOSNJE-HERCEGOVINË DHE KRYESISË SË KMSH

Nënshkruhet marrëveshja e bashkëpunimit ndërmjet Zyrës Rajonale të Ligës së Botës Islame (Muslim World League) në Bosnje-Hercegovinë dhe Kryesisë së Komunitetit Mysliman të Shqipërisë për të mbështetur dhe ndihmuar KMSH-në në aktivitetin institucional të tij në vazhdim.

Marrëveshja u nënshkrua ndërmjet Kryetarit të Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, Haxhi Bujar Spahiu dhe Drejtorit të Zyrës Rajonale të Ligës (Rabitas) në Bosnje-Hercegovinë, z. Abdullah Qari.

Po ashtu, në firmosjen e kësaj marrëveshjeje e cila u nënshkrua në selinë e KMSH-së, ishte i pranishëm edhe Ambasadori i Mbretërisë së Arabisë Saudite në Tiranë, z. Fajsal Gazi Hifdhi.

Në fjalën e tij të rastit, Kryetari Spahiu, shprehu mirënjohjen e tij për këtë mbështetje nga organizata MWL dhe gatishmërinë për konsolidimin e mëtejshëm të marrëdhënies mes dy palëve.

Ndërsa z. Qari, u shpreh se është një nder për të të ishte sot në Komunitetin Mysliman të Shqipërisë dhe të ofronte mbështetjen e organizatës së tij në ecurinë e mëtejshme të aktivitetit institucional të KMSH-së.

Implementimi i kësaj marrëveshjeje do të vijojë me vizitën e Shkëlqesisë së tij, Muhamed bin Abdulkerim el-Isa, Sekretar i Përgjithshëm i Ligës së Botës Islame, në vendin tonë gjatë muajit të ardhshëm, si dhe do të shtrihet në fusha të tjera me interes të përbashkët, si bashkëjetesa ndërfetare, bamirësia, aktivitetet shkencore, kulturore, etj.





ME SY TË PËRLOTUR TË LUTEMI

Duaja është prej adhurimeve me të rëndësishme në islam. Profeti (a.s.) në një hadith thotë: "Duaja është vetë adhurimi".¹ Kështu që kur i drejtohem Allahut me lutje, t'i drejtohem Atij me seriozitetin dhe përkushtimin e faljes së namazit apo të kryerjes së ndonjë adhurimi tjetër. Lutja drejtuar Zotit të Madhëruar është një adhurim i mbushur plot me mistere, i fshehtë dhe i shenjtë. Ajo

është sjellja më e sinqertë e adhuruesit. Është gjendja ku njeriu i drejtohet dhe kërkon diçka nga Zoti i tij me çiltërsi dhe sinqeritet.

Në ajetet si "**Kur robërit e Mi të pyesin për Mua, thuaju se Unë jam afër, i përgjigjem lutjeve të lutësit kur ai më lutet Mua**"², "**Lutmëni Mua se do t'ju përgjigjem!**"³, "**Zoti**

1. Tirmidhi

2. Bekare, 2:186

3. Gafir, 40:60

im nuk do t'ju përfillte, sikur të mos ishte lutja juaj"⁴, tregohet qartë rëndësia e lutjes. Edhe i Dërguari i Zotit (s.a.s) i ka këshilluar shokët dhe të afërmit e tij të luten, dhe vetë nuk ka pushuar së luturi Zotit përgjatë gjithë jetës së tij. Lutja e përshkruar dhe treguar me kaq madhështi zë një vend shumë të rëndësishëm në jetën e besimtarit.

Ejani së bashku t'i kthehemi kënaqësisë që na ofron Allahu - I Vetmi, I Plotëfuqishmi, I Pasuri, I Gjalli dhe Mëshiruesi i pakufishëm. Le t'i afrohem derës së mëshirës së Tij dhe Atij t'ia shtrijmë duart duke kërkuar Atë dhe ndihmën e Tij. Ai është Shëruesi, Krijuesi, Furnizuesi dhe Ai është që jep jetë e vdekje.

Një njeri i cili i ngre duart lart, i drejtohet Zotit kështu: "Të gjitha shkaqet kanë heshtur. Asnjë ngjarje nuk mund të ndikojë në rrjedhën e natyrës dhe askush nuk mund të më zgjasë dorën dhe të zgjidhë hallet e mia. Unë i ngrita duart dhe po i lutem Atij, Më të madhëruarit, Atij që vazhdimisht zërin ma dëgjon, frymëmarrjen ma ndjen, Ai i cili më thotë se është më afër se damari im i qafës, më premtan se do t'i përgjigjet lutjes sime:

Zoti ynë, paqja je Ti, paqja dhe shpëtimi janë tek Ti, dobia dhe begatia Jote janë pambarim. O i Madh e Dhurues! Ti je i pastër nga të gjitha cilësitë që tregojnë mangësi! Të gjitha lavdet dhe lavdërimet janë për Ty, nuk ka Zot tjetër veç Allahut, Ai është më i madhi, fuqia dhe forca janë të Allahut që është i Lartë e i Fuqishëm!

O Mëshiruesi i Mëshiruesve, kërkojmë prej Teje falje në këtë botë dhe në tjetrën. Zoti ynë, kërkojmë prej Teje falje dhe largimin e së keqes prej nesh në këtë botë dhe në tjetrën. Zoti ynë, dërgo mbi Profetin tonë Hz. Muhammed (a.s.) dhe vëllezërve të tij profetë, përshëndetje sa numri i krijesave të Tua, i pëlqimit Tënd, i peshës së arshit Tënd.

Zoti ynë, pastroj gabimet dhe mëkatet tona, ashtu siç pastrohet rroba e bardhë nga papastërtitë, si dhe largona nga mëkatet siç largon lindjen dhe perëndimin nga njëri-tjetri. Zoti ynë, të mbështetemi Ty nga dobësia dhe pamundësia, nga përtacia dhe kopracia, nga frika dhe plakja. Zoti ynë, mbështetemi tek Ti nga zemërashpërsia, indiferentizmi, varfëria, nga poshtërimi dhe meskiniteti; mbështetemi tek Ti nga mohimi dhe herezia, nga shkaktimi i armiqësisë, nga inati dhe smira, nga veprimi për dukje dhe sëmundjet e tjera të këqija.

Zoti ynë, mbështetemi tek Ti nga hidhërimi dhe ankthi, nga dituria që s'jep dobi, nga zemra që s'dridhet, nga lutja e papranuar dhe nga uni i pangopur. Zoti ynë, bëje burim begatie fenë që e kemi mbrojtjen e gjendjes sonë, bëje për ne të begatë jetën tjetër ku është kthimi ynë, bëje këtë jetë për ne pretekst për shtimin e të gjitha llojeve të mirësive e begative. Zoti ynë, kërkojmë prej Teje një jetë krejt të pastër dhe një kthim tek Ti që të mos të turpërohemi para Teje me të metat dhe mangësitë tona.

O Strehuesi i të pamundurve! O Burim fuqie për të dobëtit! O Shëruesi i të brengosurve! O Orientuesi i të humburve! O Zot i Lartëmadhëruar që i përgjigjesh çdo

lutjeje! Ti je Falës, e do faljen, na fal neve! Na i fal mëkatet dhe gabimet tona që nuk reshtin së përfunduari! Na bëj njerëz të plotësuar nga ana trupore, mendore dhe shpirtërore. Bashkë me dijen na shto pasurinë e zemrës dhe pastërtinë e shpirtit!

Zoti ynë! Na bëj njerëz të angazhuar në jetën shpirtërore, këmbëngulës për të qëndruar larg nga papastërtitë materiale e shpirtërore, vigjilentë ndaj dëshirave trupore, modestë e të gatshëm për të luftuar kundër sëmundjeve si urrejtja, hakmarrja, fiksimi, zilia e egoizmi!

Zoti ynë! Na bëj të durueshëm dhe të kujdesshëm! Na bëj njerëz të besimit dhe aksionit, të cilët në vend të të folurit të tepërm, t'i jetojnë ato parime në të cilat besojnë dhe që me jetesën e tyre bëhen shembull i mirë për njerëzit e tjerë!

Zoti ynë! Në qëllimin tonë qoftë gjithnjë e pëртеjmja! Na bëj prej njerëzve të besimit, të cilët janë të lidhur fort pas kënaqësisë Tënde, e që vazhdimisht avancojnë në këtë udhë deri sa të mbërrijnë tek dashuria absolute.

Zoti ynë! Na bëj prej njerëzve të sakrificës, në të mirë të besimtarëve dhe mbarë njerëzimit. Vendos midis nesh vëllazërinë, respektin, dashurinë e dhembshurinë! Të mos përçahemi asnjëherë! Por të jemi si ndërtesa të mbështetura njëra tek tjetra, duke e ndihmuar njëri-tjetrin! Na ruaj o Zot nga çdo sprovë e fitne, e cila të çon në prishjen e vëllazërisë. Vendos harmoninë midis nesh! Sjelljet tona mos lëndofshin askënd! Mos të mbajmë inat dhe mëri me asnjë njeri! Mos të ndiejmë armiqësi ndaj askujt! T'i duam besimtarët e çdo njeri tjetër që kontribuon në lumturinë e këtij populli!

Zoti ynë! Veç përpjekjeve tona, t'i japim shumë rëndësi edhe ndihmës Tënde! Në çdo vepër e në çdo lëvizje të kërkojmë vetëm e vetëm kënaqësinë Tënde!

Zoti ynë! Asnjë herë mos i hap vend në jetën tonë mendimeve të papranueshme si "ta bëj unë", "ta arrij unë suksesin", "të arrij unë rezultat"! Kushdo që ta bëjë të mirën e të bukurën, ne të gëzohemi njësoj sikur ta kishim vepruar vetë! Suksesin e të tjerëve ta pranojmë edhe si suksesin tonë!

Zoti ynë! Na udhëzo që të mos merremi me mangësitë e gabimet e të tjerëve, duke mos arritur të shohim ato tonat! Na bëj prej atyre njerëzve që bëjnë vazhdimisht llogarinë e brendshme vetjake, e që mundohen t'i plotësojnë mangësitë e tyre! Të jemi përfaqësues të së mirës dhe një shembull i mirë për të tjerët!

I lartësuar është Allahu i Madhëruar nga përshkrimet e të tjerëve dhe vetëm Atij i takon falënderimi i pakufishëm. Paqja e bekimi i Zotit qoftë mbi të Dërguarit e Tij.

Ne lutemi për Profetin e njerëzimit gjithmonë, lutemi për familjen e tij, lutemi për shokët e tij që i ishin përkrah në çdo situatë të dhimbshme me një besnikëri dhe sinqeritet të paparë. Lutemi për ata njerëz që në të kaluarën dhe në të ardhmen do të ndjekin me devocion udhëzimet e Zotit, të përcjellura nga i dërguari i fundit.

Medreseja e Tiranës

NJË SHEKULL PËR ARSIMIN E DITURINË



Intelektuali i njohur, z. Xhemal Balla ish-medresist dhe më pas mësues flet për kushtet në të cilat u hap Medreseja e Tiranës në vitin e largët 1924, pedagogët dhe medresistët e parë si dhe rolin dhe kontributin e dhënë prej tyre në shoqërinë e asaj kohe e më vonë. Në vlerësimin e tij Medreseja e Tiranës ka qenë dhe mbetet një ndër shkollat elitë jo vetëm të kryeqytetit, por të gjithë Shqipërisë, pasi në bankat e saj janë përgatitur qindra studiues, inxhinierë, mjekë, mësues, vajzë etj., që kanë punuar me ndërgjegje të lartë në sektorë të ndryshëm të jetës.

Z. Balla sjell në vëmendje momente nga rihapja e Medresesë në vitin 1991, ku edhe pse në kushte të vështira e mungesë të theksuar ambientesh e baze didaktike, Medreseja ruajti profilin e saj, duke ofruar për nxënësit e saj arsimin dhe edukimin e duhur të ndërthurur me frymën fetare e kombëtare, mision të cillin vazhdon ta kryejë me përkushtim edhe sot e kësaj dite.

Për medresetë, si institucione serioze të arsimit kombëtar fetar islam, mund të flasim vetëm në fillimet e shekullit XX, pas Shpalljes së Pavarësisë. Në ballë të tyre qëndron sigurisht Medreseja e Tiranës, që u hap më 1924 për të plotësuar nevojat për kuadro fetarë. Cilat ishin kushtet në të cilat u hap kjo shkollë?

Pas shpalljes së pavarësisë klerikët shqiptarë radhitën bashkë me personalitete politike e shoqërore në mbrojtje të saj. Vehbi Dibra ishte zgjedhur në krye të pleqësisë, i ngarkuar nga Kuvendi me detyrën e Myftiut të përgjithshëm të Shqipërisë. Ai filloi menjëherë me riorganizimin e institucioneve fetare në Shqipëri e deri në ngritjen e zyrave të Sheriatit Islam. Këto probleme ai i bën objekt diskutimesh në mbledhjen e qeverisë së Vlorës, datë 5 maj 1913 (Arkivi Qendror, fondi 71, dosje 2, dokumenti 8135). Ndërmjet të tjerash në të shkruhej: "Myftinj të do të vihen në dispozicion të Hirësisë së tij, Shejhul Islam i Shqipërisë dhe funksioni i tyre do të dekretohet prej tij". Administrata fetare u krijua mbi baza të administratës shtetërore si p.sh. prefekturës i përgjigjej Myftiu, N/Prefekturës – N/Myftiu e me radhë, të gjitha në varësi të qeverisë. Një eveniment me rëndësi në vitin 1916 ishte krijimi i gjyqit të Naltë të Sheriatit Islam me kryetar Kryemyftiun e Shqipërisë H. Vehbi Dibra. Filloi reforma fetare e shoqërore, që arriti kulmin me ndarjen nga kalifati i Turqisë në vitin 1923, me organizimin e kongresit të parë mysliman më 24 shkurt deri 13 mars, kryesuar nga Dërvish Hima. Në këtë kohë pushteti i Ahmet Zogut kishte

aprovuar masa ligjore që synonin kontrollin mbi bashkësitë fetare. Kongresi zgjodhi komisionin për hartimin e statutit si dokumenti më i rëndësishëm i tij. Në nenin 6-7 përcaktohej zgjedhja e Këshillit të Naltë të Sheriatit Islam me kryetar Vehbi Dibra. Ky këshill ngarkohej që të ngrinte Medresenë e Naltë, si nevojë urgjente për Shqipërinë. Kjo u vendos në një kohë kur nuk ishte krijuar gjimnazi i Tiranës, por ekzistonte vetëm shkolla teknike.

Medreseja u hap në vitin 1924 me vendim të qeverisë shqiptare për efekt license. Në zbatim të artikullit 60 të statutit të Komunitetit Mysliman, Medreseja e Përgjithshme konsiderohej si një institut mësimor fetar e kombëtar, ku përfshinte tre kategori: fillore – lice - universitet, ku secila periudhë të ishte nga 4 vjet. Këshilli i Naltë i Sheriatit në fillim propozon hapjen e tri klasave për mungesë të godinës e anës financiare. Nga çdo prefekturë do të pranoheshin nga pesë nxënës, që u siguronin dhe financimin e tyre. Këshilli i Naltë emëroi si drejtor Qamil Balën, pjesëmarrës në kongresin islam dhe anëtar i Këshillit të Naltë të Sheriatit. Shkolla do të funksiononte me një rregullore të aprovuar prej 92 nenesh, me personel tërësisht shqiptar, me programe e organizim bashkëkohor të hartuar nga teologët e Komunitetit Mysliman.

Më 24.02.1924 u regjistruan 24 nxënës. Personeli arsimor ishte: Hafiz Ali Korça, mësues i gjuhës arabe; Sulejman Kadiu, mësues i Kur'anit, fikhut dhe gjuhës shqipe; Major Rexhep Berati, mësues i matematikë-gjeometri; kapiten Musa Puka, mësues i gjimnastikës; Haki Tefiku, mësues i histori-gjeografi; Pertef Pogoni, mësues i frëngjishtes; Jashar Qemali i higjienës; Qamil Bala i shkencës; Gani Strazimiri, mësues i vizatimit; doktor Sabriu, vizitë mjekësore javore. Në semestrin e dytë, 01.09.1924 emërohen profesorë të rinj si Haxhi Tahiri, Haxhi Dashi, Sali Çela, Emin Jakova e Avni Zajmi.

Në kongresin e III islam që u mbajt më 6 korrik -3 gusht 1929 u vendos që Medreseja të emërtohej "Medrese e Përgjithshme", për shkak se u mbyllën medresetë e qarqeve. Në vitin 1931 përfundoi së ndërtuari godina e re e Medresesë dhe në inaugurimin e saj, në fjalën e hapjes foli politikani e sociologu shqiptar Mehdi Frashëri, ku ndërmjet të tjerash do të citonte: "Ky qe një sihariq për tërë botën islame shqiptare. Përparimi i vullshëm për ne shqiptarët është një nevojë e jetës. Medresetë do të jenë foleja e prijësve të fesë islame në Shqipëri, e duhet të konfirmohen me frymën e shekullit brenda të cilit jetojmë." (Zani i Naltë, Nr. 6, fq. 154-158)

Më 23.10. 1932 këshilli i përhershëm i Komunitetit Mysliman organizoi shpërndarjen e parë të 16 diplomave të studentëve, maturantëve të kësaj shkolle. Numri i nxënësve erdhi duke u shtuar saqë në vitin 1936 arriti në 100 nxënës të brendshëm dhe 25 nxënës të jashtëm. Evenimenti më i rëndësishëm ishte vizita e një ministri nga SHBA i shoqëruar nga kryetari i Komunitetit Mysliman Shqiptar, dr. Behxhet Shapati.

Medreseja formoi fizionominë e një institucioni me vlera islame ku merrej formim i shëndoshë fetar e kombëtar, ndaj edhe fitoi emër të mirë në të gjithë vendin e më gjerë. Cili ka qenë profili i medresistëve të parë?

Profili i medresistëve të parë ka qenë i shkëlqyer. Kështu Shaban Demiraj nga Vlora mbaron me gradën "Lavdrueshëm" e arin të bëhet kryetar i Akademisë së Shkencave të Republikës së Shqipërisë; Sali Ferhati, vaiz shëtitës në Berat e më vonë Myfti i Peshkopisë; Shefqet Jashari mësues feje e më vonë Myfti i Peqin-Shijak. Po kështu emërohen 8 maturantë vaizë shëtitës si: Enver Beqiri, Hafiz Sahiti, Limon Bushati, Shefqet Balla, Hasan Selami, Adem Mehmeti etj. Më datë 24.06.1939 të gjashtë maturantët shkojnë në Peruxhia të Italisë për të ndjekur kursin veror të gjuhës italiane shoqëruar nga profesori i tyre. Studentët që mbaruan jashtë si Vexhi Demiraj në Kajro, renditet studenti i dytë që merr diplomën me rezultate të larta, emërohet në Medrese profesor i filozofisë në vitin 1939, zgjidhet sekretar i shoqatës bamirëse kulturore dhe e rinisë myslimane në kryeqytet dhe kryeredaktor i revistës "Arsyeja"; Sadik Bega diplomohet në Kajro, emërohet drejtor i revistës "Kultura Islame"; Sherif Putra diplomohet në Universitetin "Lahora" të Indisë dhe punësohet redaktor i revistës "Kultura Islame" e më vonë drejtor i Medresesë. Vexhi Buharaja fiton konkursin letrar të shpallur në fletoren "Tomorri" për prozë e poezi dhe bëhet një nga orientalistët më të shquar shqiptarë në përkthimin e mjaft veprave nga gjuhët e lindjes.

Cili është kontributi për shoqërinë i të diplomuarve në këtë institucion fetaro-arsimor?

Krahas detyrave fetare si imam, vaiz, myfti si dhe u përmend më lart, medresistët kanë

kontribuar dhe në sektorë të ndryshëm të jetës civile-dominon profesioni i mësuesit, pasi një pjesë e konsiderueshme u diplomuan në Universitetin Shtetëror në degën e mësuesisë si: Sefer Bajraktari, Mehmet Balla, Mehmet Sinella, Ismail Muçej, Besim Ali Mehmeti etj, të diplomuar para çlirimit të vendit, ndërsa mbas vitit 1944, gjatë pushtetit komunist ka një numër më të madh medresistësh nga Kavaja, Durrësi, Tirana, Peshkopia që morën arsimin e lartë e kontribuuan në arsim, por edhe në degët e tjera të ekonomisë, që po të rendisim emra e kalojnë numrin 30. Në Tiranë Ibrahim Balla, Faik Kasollja, Ali Basha në Universitetin e Tiranës, Xhemal Balla, drejtor e inspektor arsimit, Ali Hoxha, Muhamed Xhimdulla, Fahri Doçi etj; në zonën e veriut, Hekuran Balliu, Idriz Xhaferri, Kujtim Gjinishi, drejtor arsimit, Zyhdi Çaçja etj.

Pas ardhjes së komunistëve në pushtet, si feja e besimi në përgjithësi, medreseja pati goditje me ashpërsi në rritje. A ka pasur raste ku profesorë apo medresistë janë persekutuar dhe burgosur nga regjimi totalitar?

Ardhja në pushtet e komunistëve solli reforma në fe dhe në përndjekjen e kuadrove të saj. Eksponentë të shquar të klerit mysliman u persekutuan e u burgosën si: Hafiz Ali Korça, Hafiz Ibrahim Dalliu, Hafiz Ismet Dibra, Hafiz Sabri Koçi, Faik Hoxha, Ismail Muçej, Haki Sharofi, Jonuz Buliqi, Ibrahim Hasanaj, Haxhi Mustafa Varoshi, Hafiz Sherif Langu, Selim Gashi, Sheh Ali Pazari, Shyqyri Myftiu i ekzekutuar; Sheh Ibrahim Karbunara i pushkatuar etj, etj. U hoqën nga puna ose u burgosën të gjithë sepse dyshoheshin se ishin kundër pushtetit.

Mbas shpalljes së kushtetutës së re në mars të vitit 1946, shteti e ashpërsoi edhe më shumë luftën jo vetëm kundër klerit mysliman por edhe ndaj Medresesë. Ju hoq titulli Medrese e Naltë dhe u la vetëm shkollë e mesme dhe vazhdoi të funksionojë sipas programit të shkollave profesionale kryesisht të pedagogjikes. Ministria e Arsimit gradualisht u përpoq që programi i shkollës të shkojë drejt laicizmit. Ministria e Drejtësisë me shkresë datë 27.01.1947 kërkon lirimim e xhamive për shkollën 7 vjeçare "Misto Mame". Gazeta "17 Nëntori", organ i Frontit Demokratik të Tiranës e datës 23.12.1946, boton artikullin me titull

“Dhe mban akoma emrin shkollë!?”. Ndërmjet të tjerash thuhet: “Thuhet se në medrese punohet sipas programit të Ministrisë. A mund të jetë e vërtetë kjo? Pse rrinë në Medrese 170 nxënës? Mos vallë u pëlqen?... Nxënësit kanë kërkuar suprimimin e Medresesë etj. etj. Kjo ishte një nxitje kundër Medresesë. Hoqi ditën e premtë si ditë pushimi dhe e kaloi të dielën për të penguar faljen e ditës së premtë.

Këshilli i Përgjithshëm në vitin 1953 me nxitje nga lart pushoi nga puna profesorët e medresesë si: Haki Narazani, Imer Saraçi, Jonuz Bulej, Selman Stërmasi etj. Në vitin 1964 me vendim Nr. 1 datë 22.08.1964, Këshilli i Përhershëm e mbyll Medresenë dhe ndalon propagandën fetare me urdhër nga lart.

Si ka qenë niveli i Medresesë së Tiranës gjatë periudhës së parë, krahasuar edhe me shkollat e tjera në kryeqytet?

Niveli i programeve dhe kërkesave ka qenë i lartë. Kanë dalë nxënës të shkëlqyer si Shaban demiraj, Vexhi demiraj, Vexhi Buharaja që kanë triumfuar në konkurset e organizuara me shkollat e qytetit. Këta kanë arritur grada të larta shkencore në jetën e tyre dhe i kanë shërbyer kombit.

Medreseja e Tiranës u rihap në vitet '90 kur në Shqipëri ishte lënë i lirë besimi, po ringjallej jeta fetare. Si e kujtoni rihapjen e saj?

Me ardhjen e demokracisë në vendin tonë, u rihap Medreseja në vitin 1991-1992 ku për bazë të lëndëve të kulturës së përgjithshme mori gjimnazin të aprovuar nga Ministria e Arsimit, me të drejtë që nxënësit të vazhdojnë studimet dhe në Universitetin Shtetëror. Lëndët fetare përfshijnë: Kur'an, besim, histori islame, Akaid, Fikh, Usuli Fikh, Hadith, Tefsir, gjuhë arabe. Fillimet qenë shumë të vështira, pa baza didaktike dhe pa godinë. U përshtatën disa magazina pranë Xhamisë së Kokonozit, Tiranë. Gëzimi që i madh si nga ana e drejtuesve ashtu dhe e besimtarëve myslimanë. Ajo ditë u kthye në ditë feste. Bërthamën e personelit mysliman e bënë ish medresistët që ishin diplomuar në Universitetin e Tiranës dhe kishin punuar në arsim si: Ibrahim Balla (drejtor); Xhemal Balla (n/drejtor); Selim Stafa (arabisht); Ali Hoxha (arabisht e gjuhë letërsi); Hafiz Shaban Saliaj,

Ali Basha, Mehmet Sinella, Hekuran Balliu, Rrahman Balla, Ismet Tançica, Sadik Çollaku etj.

Cila ishte pritja që i bëri populli i Tiranës?

Gëzimi ishte i papërshkrueshëm. Besimtarë dhe intelektualë morën pjesë në rihapjen e saj. Tarik Llagami, ish drejtor i gjimnazit “Partizani” në Tiranë bën një reportazh të bukur për hapjen dhe perspektivën e saj dhe rolin për përgatitjen e kuadrove fetare vendas. Baza materiale u sigurua me ndihmë nga shkollat e shtetit si “Fan Noli” e ndonjë tjetër. Ajo funksionoi me seriozitetin më të madh në zbatimin e programeve mësimore derisa krijohen mundësitë për të kaluar në ish godinën e saj të zaptuar nga shëndetësia me fakultetin stomatologjik.

Ju jeni një kuadër i vjetër e me përvojë të gjatë, sipas jush cilat janë përparësitë e Medresesë në krahasim me institucionet e tjera arsimore të sistemit parauniversitar?

Dallimi qëndron vetëm në futjen e programit të disa lëndëve fetare islame, që e formojnë nxënësin nga ana e besimit. Ndërsa lëndët e kulturës së përgjithshme janë të barabarta me programin e gjimnazit shtetëror dhe nxënësi që mbaron këtë shkollë nga parimi edukativ-themelor është i barabartë me ta dhe nuk ka asnjë pengesë për të vazhduar shkollën e lartë si brenda vendit ashtu dhe jashtë tij.

Në vitet e para Medreseja provoi vështirësi të mëdha e serioze që i kapërceu gradualisht, duke filluar nga mungesa e ndërtesës e mjeteve didaktike-mësimore, kuadri i kualifikuar mësimdhënës, programet e deri te tekstet mësimore aq të nevojshme. Ç'mund të na thoni për medresenë sot?

Sot Medreseja radhitet ndër shkollat më të mira me programe e bazë didaktike bashkëkohore, që i plotëson nevojat e zbatimit të programeve me laboratorë përkatëse si biologji-kimi, fizikë, gjuhë të huaja, informatikë etj. Kjo shkollë e ka afirmuar veten me pjesëmarrjen e nxënësve të saj në konkurse brenda vendit krahas shkollave të tjera si dhe jashtë vendit duke fituar çmime të vendeve të para, të dyta e të treta.

Nxënësit e ndiejnë veten të privilegjuar që vazhdojnë këtë shkollë.

Profeti ynë a.s.

është profeti i mëshirës

Një herë, një burrë kishte një brenjë e donte t'ia shpjegonte Profetit Muhamed (a.s.).

Rrekej që të mund t'ja shpaloste atij, por fatkeqësisht nuk e merrte dot guximin për ta bërë, gjersa një ditë, arrin t'a nxjerrë atë shkullm zjarri dhe dert të madh që e rëndonte.

I thotë: "O i Dërguar i Allahut, unë kam bërë një gabim, një kusur... dhe është aq i madh sa s'di si ta them.

Para se të bëhesha mysliman, në periudhën e injorancës kur adhuroheshin idhujt, në atë kohë errnaje, kam bërë një gabim që më rëndon si vullkan në brendësi, e që më shkudon sa herë e kujtoj e s'ndalet, një zë që jehon e s'shuhet...


Unë kisha një bijë, një fëmijë të vogël. Ishte e bukur dhe e dashme. Një ditë i thashë gruas time që ta bënte gati se do ta çoja te daja. Gruaja heshti. Ajo e dinte mirë, mirëpo ç'mund të bënte një grua kundër meje asokohe. E bëri gati duke u munduar të mos binte në sy të vajzës, duke i fshehur lotët e saj përbrenda, t'i shkisinin përbrenda...

E thirra vajzën pranë meje. Kur e thirra, aq u gëzua! U gëzua duke thënë se shiko, im atë më jep rëndësi e kujdeset për

mua dhe më erdhi pranë duke vrapuar! E dini që fëmijët vijnë vrapazi duke buzëqeshur kur ngazëllehën, dhe mu ashtu erdhi dhe ajo. Pastaj, e zura për dore. Kur e kapa për dore, u gëzua edhe më shumë. Duke buzëqeshur, me pa brenda në sy e më tha: "Babai imi dashur!... Fëmijët gëzohen kur etërit u kapin duart. Pastaj ecëm së bashku, dora e saj e vockël nën dorën time të madhe, ecëm... Ajo u gëzua edhe më shumë, sepse fëmijët gëzohen kur ecin me etërit e tyre... dora e saj nën dorën time, ecëm... Më pa brenda syve e më tha: "Babai imi dashur!". I qeshnin sytë.

Ashtu për dore e çova buzë gropës që e kisha bërë gati që më parë. Ja lëshova dorën dhe i thash të shilte në gropë, e teksa shilte, i dhash një shqelm dhe e shtyva brenda. Teksa ra brenda, cepi i rrobës time të këmba, m'u bë pis. Prej buzëve të saj, sërish rridhte verbi "Babai imi dashur!" dhe mundohej të shkundte rrobën që m'u bë pis... i dhash një shqelm tjetër dhe e mbulova me dhé të gjallë.

Burri rrëfente, Profetit lotët i rridhin krua për faqesh... Qau Profeti dhe qanë shokët e tij që ishin pranë. Madje disa



u zemëruan e u nxenë me atë burrë: "Përse rrëfen diçka të tillë?! Përse e trishton të Dërguarin e Allahut kështu?!" mirëpo i dërguari i Zotit (a.s.) nuk i la. U kthye nga ai burrë dhe i tha ta tregonte edhe një herë. Ai filloi sërish të rrëfente... rreth flokëve të bukur të vajzës, rreth duarve të saj të vockla, rreth vrapimit të saj të buzëqeshur dhe zërit të saj të ëmbël tek thosh "Babai im i dashur!"...pastaj tha, një gropë, një gropë e errët... një shqelm... një britmë... një klithmë e fundme... "Babai im i dashur!... Burri foli, Profeti qau e qau, e gjithë Medinja qau, kafshimi i gjarprit në thembrën e Ebu Bekrit qau, këmisha e grisme e Omerit qau, gjurma e kamxhikut në shpinën e Bilait qau... qajtën...

Edhe një herë tha Profeti (a.s.)! Burri ua tregoi sërish... s'ish veç historia e vajzës së vet, por i të gjitha vajzave që për së gjalli qenë groposur... shpjegoi mekjen e të gjitha shkretëtirave, dhembjen pa prà të të gjitha nënave... Qau... Qajtën...

Më pas, i dërguari i Allahut (a.s.) iu kthye atij burri: "Tani nise gjithçka nga e para! Nisja gjithçkaje prej fillimi..."

Profeti ynë (a.s.) është dera më e bukur për të gjithë ata që

duan t'ja nisin nga e para, fryma më e bukur e pranverës, pika më e bukur e shiut.

Profeti ynë (a.s.), për ata që duan t'ja nisin nga e para, për ata që kanë bërë gabime, është ngushëllimi më i mirë, madje jo vetëm për ata që kanë bërë gabime të vogla, që kanë lënë mangët adhurimet, që kanë përgojuar, që thonë 'do ja them në sy atij!' e nuk gjejnë guximin t'ja thonë...jo!...edhe për ata që kanë groposur vajzat e tyre.

Sigurisht, me tregimin e kwsaj historie, profeti Muhamed (a.s.) sikur donte t'u thoshte tw pranishmwve: "E shihni se si ishit mw pwrpara, dhe shihni tani se si ju lartwsoi Zoti me Islamin."

Tani jemi në prag Ramazani, e ky muaj i shenjtë është më i bukur për ata që duan t'ja nisin nga fillimi, është mëngjesi më i bukur për ata që duan të çelin sytë e të zgjohen, me i bukur të ezanit,

Është dera më e bukur e Xhenetit!

Nata e mirë e Israsë dhe Miraxhit

Ngjarja e Israsë dhe Miraxhit ka ndodhur afërsisht 16 muaj para se Profeti Muhamed (a.s.) të emigronte në Medinë, saktësisht në natën e 26 që lidh natën e 27 të muajit Rexhep të vitit 621 miladi, në vitin e 12 të profetësisë së tij kur ai ishte 52 vjeç. Hz. Muhamedi (a.s.), me urdhrin e ardhur nga Allahu i Lartë, është dërguar natën nga Mesxhidi Haram (Meke) në Mesxhidi Aksa (Kuds). Ky dërgim quhet "isra" që do të thotë "udhëtim natën". Dhe prej këtu, është ngjitur në qiell dhe kjo ngjitje apo lartësim quhet "miraxh". I gjithë ky udhëtim është bërë me trup dhe shpirt nga Profeti Muhamed (a.s.). Këtë specifikë e bën të qartë në Kur'an ajeti i parë i sures Isra: **"I lavdëruar qoftë Ai që e mbarti robin e Tij (Muhamedin) natën nga Mesxhidi Harami (në Mekë) për në Mesxhidin e Aksas (në Kuds), rrethinën e së cilës e kemi bekuar, për t'i treguar atij disa nga mrekullitë Tona. Ai, me të vërtetë, dëgjon dhe sheh çdo gjë."**

Nuk ka dyshim se Miraxhi është një eveniment në kundërshtim me ligjet e natyrës që njohim ne. Por nuk është jashtë fuqisë dhe kompetencës së Allahut (xh.sh.), zotëruarit të fuqisë absolute që ka krijuar çdo gjë dhe që i jep vazhdimësi gjithësisë në harmoni të plotë.

Pyetje: A mund të pranohet logjikisht ndodhitë e Israsë dhe Miraxhit?

Përgjigje: Lëvizjet janë nga më të shumëllojshmet për sa i përket Fuqisë së krijimit nga Allahu (xh.sh.). Për shembull, dihet se sa të ndryshme janë shpejtësitë e zërit, dritës, elektricitetit, shpirtit dhe imagjinatës me njëra-tjetrën. Shkencërisht ne jemi të informuar edhe për shpejtësitë e yjeve, për të cilët mendja jonë mbetet e shtangur. Atëherë, përse të na vijë çudi kur trupi i Profetit (a.s.) t'i përshtatet shpejtësisë së shpirtit të tij mjaft të shpejtë gjatë natës së Miraxhit?

Njeriut mund t'i vijë ndër mend një mori gjërash për dhjetë minuta në ëndërr, që mund t'i jetojë brenda një viti.

Për më tepër, njeriu sheh dhe dëgjon aq shumë gjëra në një ëndërr, sa që kur i mbledh dhe i thotë ato, i duhet disa orë. Përfundimisht, është e mundur të pranosh logjikisht se vetëm për disa minuta mund të kalohet një distancë mijëra vjeçare.

Historiku i Israsë dhe Miraxhit

Njëra prej ngjarjeve më të rënda të periudhës së Mekës për myslimanët si dhe më e vështira për t'u duruar prej tyre, ishte vdekja e dy njerëzve të mëdhenj që u patën dalë krah dhe u qenë bërë mbështetje profetit dhe myslimanëve, Ebu Talibit xhaxhait të profetit dhe Hatixhes, gruas së Profetit (a.s.). Kjo situatë rëndohet edhe më tepër kur Profetin e përzunë me gurë nga qyteti i Taifit. Të gjitha këto ngjarje të hidhura të ardhura njëra pas tjetrës, e dëshpëruan Profetin (a.s.), i cili në fund të fundit, ishte njeri prej mishi dhe kocke. Megjithatë, ai kurrë nuk ra në pesimizëm. Në një gjendje të tillë ndodhi ngjarja e Israsë dhe Miraxhit, ku Profeti u bë dëshmitar i shumë bukurive hyjnore, i një dukurie të jashtëzakonshme të realizuar jashtë kufizimeve kohore e hapësinore, në një mënyrë të pashpjegueshme me mend e të pashprehshme me fjalë. Ai bisedoi me Zotin dhe u ngushëllua prej Tij për ngjarjet e fundit që kishte përjetuar.

Në një natë thotë Profeti, çatia e shtëpisë sime u hap dhe zbriti engjëlli Xhibril (Xhebrail). Ai i hap gjoksin profetit dhe pasi e lan zemrën e tij e vendos përsëri në vend. Më pas Profeti hip në një kafshë me ngjyrë të bardhë që ishte Buraku. Fjala "Burak" vjen prej fjalës "berk" që do të thotë vetëtimë. Distanca e hapit të tij ishte tej largësisë së shikimit. Hz. Muhamedi (a.s.) në shoqërimin e Xhibrilit mbërrin në Mesxhidi Aksa, ku u prin si imam në namaz të gjithë profetëve të Zotit.

Më pas fillon ngjitjen në qiell duke iu zbuluar të gjitha sekretet dhe misteret hyjnore të gjithësisë lëndore dhe shpirtërore. Profeti tregon që, Xhibrili u ngjit me mua në qiellin

e parë dhe kërkoi që ata të hapen. Një zë e pyeti "Kush je ti?" dhe ai iu përgjigj: "Jam unë Xhibrili". Zëri e pyeti përsëri: "Kush është me ty?" dhe ai iu përgjigj: "Muhamedi". Pastaj ai e pyeti përsëri. "A është i ftuar?" Dhe ai u përgjigj që ishte. Thanë: Mirë se të vijë! Ç'vizitor i mrekullueshëm që ka ardhur! Kur kalova nëpër këtë qiell, aty pashë Ademin (a.s.)! Xhibrili më tha: Ky është babai yt, Ademi. Përsëritet, pra! E përsëritet dhe ai ma ktheu selamin e më tha: Mirësevjen, o bir i drejtë dhe Profeti i drejtë!

Hadithi vazhdon duke përshkruar Profetin e dashur dhe Xhibrilin, duke u ngjitur lart. Në qiejt me radhë Profeti Muhamed (a.s.) takon profetët **Jahjanë** dhe **Isanë, Jusufin, Idrizin, Harunin, Musanë,** dhe **Ibrahimin**. Secili prej tyre e përshëndeti si vëlla Muhamedin e bekuar duke u lutur për të. Profeti vazhdon mbi qiellin e shtatë në vendin e quajtur Sidretu'l-Munteha. Profeti Islam vazhdon më tej i vetëm dhe paraqet para Zotit përshëndetjen e njohur si et-tehijatu, të cilën e këndojmë kur jemi ulur në namaz. "Përshëndetjet, respekti, lavdia dhe zotërimi i takon Allahut (xh.sh.)". Allahu i plotfuqishëm urdhëroi: "Shpëtimi, mëshira dhe bekimi i Zotit janë për ty, o Profeti Im!" I dërguari i Allahut shtoi: "Shpëtimi qoftë për ne dhe për njerëzit e sinqertë të Zotit!" Atëherë, e gjithë bota engjëllore, njëzëri shqiptoi maksimën e dëshmisë, duke dëshmuar njësimin e Allahut të lavdëruar si dhe Muhamedin si rob dhe të dërguarin e Tij.

Me rastin e kësaj vizite qiellore Profetit (a.s.) do t'i jepen më vonë 12 principet e Islamit, që përmenden në ajetet 22-39 të sures Isra:

- 1- Mos i bëni ortak Allahut
- 2- Respektojini dhe bindjuni prindërve
- 3- Jepuni te drejtën që u takon të afërmeve, të varfërve dhe udhëtarëve
- 4- Mos shpërdoroni. Mos ji koprrac e as dorëlëshuar
- 5- Mos i vrisni fëmijët nga frika e varfërisë
- 6- Mos iu afroni imoralitetit
- 7- Mos vrisni njeri pa të drejtë
- 8- Mos abuzo me pasurinë e jetimit
- 9- Mbajni premtimet
- 10- Mos u shmangni prej drejtësisë në matje e peshim
- 11- Mos ndiq atë për të cilën nuk ke dijeni dhe përbahu nga pohimet e pabaza dhe hamendjet
- 12- Shmangu nga mburria dhe mendjemadhësia.

Urdhëresa për Profetin dhe ymetin e tij që mori prej Miraxhit ishin pesë kohët e namazit. Hadithi kuds shpjegon se si Allahu e urdhëroi profetin që namazi duhej të falej 50 herë në ditë. Gjatë rrugës së kthimit, ai takoi Musain, i cili i thotë se njerëzit nuk mund ta kryenin kaq shumë këtë detyrë. Ai me përlulesi u rikthye disa herë në prezencë të Allahut derisa numri i namazeve u zvogëlua në 5, por me shpërblim sa për 50. **"O Muhamed! Ato janë pesë namaze, çdo ditë e natë, për çdo namaz ka dhjetë shpërblime. Ato janë pra 50 namaze..."** Me gjithë këtë lehtësim të madh Musa (a.s.) i tha Profetit që të kërkonte përsëri lehtësim, por përgjigja e Profetit (a.s.) do të ishte kuptimplotë: "Jam kthyer atëherë shumë te Zoti im, sa që më vjen turp prej Tij." (Muslim, Kitabu'l iman, hadithi 266).

Profeti (a.s.) për Miraxhin do të shprehet: "Nuk kam parë kurrë diçka më të mirë sesa ai". (Ibn Hisham, Sire Neveuie, Kısatu'l Miraxh, f. 404)

Kur Profeti lajmëroi të nesërmen për Miraxhin, politeistët ngulmuan në pyetje. E pyetën për Kudsën dhe Mesxhidin Aksa. Edhe pse Profeti nuk i pat shkelur kurrë më parë ato vende, iu përgjigj një për një pyetjeve të politeistëve. Megjithatë, në zemrat e tyre nuk ndodhi ndonjë anim. Politeistët shkuan e i thanë Hz. Ebu Bekrit: "E dëgjove? Shoku yt thotë se mbrëmë shkoi në Kuds dhe prej atje, u ngjiti në qiell!" Sikur deshën të thonin "Tani e teproi!" Hz. Ebu Bekri, i cili ende s'ish takuar me profetin dhe s'e kish dëgjuar akoma ngjarjen prej vetë atij, i pyeti: "Këto që po thoni, Muhamedi vetë i thotë?" "Po!" – Iu përgjigjën ata. "Nëse i thotë vetë ai, domethënë se janë të vërteta" – u përgjigj pa asnjë mëdyshje Ebu Bekri. Për këtë përgjigje të prerë dhe me besim ta patundshëm, Profeti e mbiquajti atë "Sidik", "Besnik", që do të thotë person i drejtë dhe i sinqertë në besim pa pasur as dyshimin më të vogël.

Edhe dy detaje të rëndësishme me ndikimin frymëzues të Israsë dhe Miraxhit:

1. Israja dhe Miraxhi ka frymëzuar edhe ndjekësit e traditave të tjera fetare. Rast tipik është ndikimi i saj në konceptimin e veprës "Komedia Hyjnore" të Dante Aligerit. Me plot të drejtë, italianët e konsiderojnë Danten si poetin e tyre kombëtar dhe veprën "Komedia Hyjnore" si poemë të shenjtë. Në këtë vepër Dante ndërmerr një udhëtim imagjinar në Botën e Përtejme, në Ferrin dhe Parajsën. Studiues të ndryshëm lindorë, por edhe evropianë, kanë dhënë idenë se Dante Aligeri është mbështetur konsiderueshëm te rrëfimet e profetit Muhammed (a.s.) për ndodhinë e Miraxhit.

2. Sigurisht që nuk mund të lihet pa përmendur se "Miraxhi" i profetit Muhamed përbën udhëtimin e parë të njeriut në hapësirat qiellore. Udhëtimi i profetit Muhamed përbën një horizont për t'u arritur, edhe ky udhëtim-mrekulli në kufijtë e universit përbën një kulm drite që e fton njeriun për t'iu afruar.

Afro 200 vjet pas udhëtimit qiellor të Muhamedit dhe nën ndikimin frymëzues të ajetit kuranor, Abbas Ibn Fernas bëri përpjekjet e para për të fluturuar. Këto përpjekje vijuan, pas afro 800 vitesh, me Leonardo Da Vinçin. Dhe, më tej, me ndërtimin e avionëve, fluturimin rreth Tokës të Gagarinit, zbarkimin në Hënë etj. Sot, pas afro 14 shekujsh, shkencë vazhdon të synojë depërtimin në hapësirat qiellore.

Fluturimet e para, lëshimi i satelitëve, shkelja e njeriut në Hënë, studimi i drejtpërdrejtë i Marsit, studimi i sistemit tonë diellor e më gjerë, janë prova se njerëzimi, dashur pa dashur, ka ecur në rrugën e arritjes së horizonteve të mrekullive kuranore dhe të profetit Muhamed (a.s.) Kjo tregon saktësinë e Kuranit, çdo fjali e të cilit është një argument më vete.

Nëse duam edhe më tej ta ndjekim Profetin e Zotit në miraxhin e tij, mos të ndahemi nga falja e namazit. I kemi dhënë besën Zotit se namazin do ta falim dhe Profetin (a.s.) në miraxhin e tij do ta ndjekim. Miraxhi është treguesi më i mirë se si besimtari mysliman duhet të marrë si model Profetin Muhamed (a.s.).

Udhëzimi i Profetit a.s. në
bashkëjetesë me të tjerët

“Në të dërguarin e Allahut ka një shembull të mrekullueshëm për atë, që shpreson tek Allahu dhe Dita e Fundit dhe e përmend shumë Allahun.” (Ahzabë, 21)

I dërguari i Allahut, paqja qoftë mbi të!, na ka lënë neve katër modele në lidhje me bashkëjetesën me të tjerët. Njëri prej tyre është modeli që ka ekzistuar në Mekën e Ndritur kur situata atje ishte “durimi dhe bashkëjetesa”. Modeli i dytë është modeli i qëndrimit të myslimanëve në Habeshe dhe situatë atje ishte “besëlidhja dhe kooperimi”. Modeli i tretë është modeli i Medinës në etapën e parë të saj dhe situatë atje ishte “çlirimi dhe bashkëpunimi”. Modeli i katërt ishte ai i Medines në etapën e fundit të saj dhe situatë atje ishte “drejtësia” dhe “vetëdija para përpjekjes”.

Qëndrimi i myslimanit në shoqëri nuk del jashtë këtyre katër kontureve. Është obligim yni që të përfitojmë shumë nga secili prej këtyre modeleve të paraqitura duke patur parasysh se është një metodologji e zgjedhur vetë nga Allahu i Lartësuar. Është detyrë e jona që t’i perceptojmë realitetet e këtyre modeleve, që janë të vlefshme e të dobishme për myslimanin në çdo situatë e rrethanë, e të kuptojmë traditën e të Dërguarit tonë, paqja qoftë mbi të!, përmes rrjedhës historike dhe pozitave të tij.

Nga ajo që na transmetohet me saktësi nga Ibn Habbani , i dërguari i Allahut, paqja qoftë mbi të!, ka thënë: “Nga mençuria e familjes së Daudit është që besimtari të jetë perceptues i çështjes së tij dhe i njohur me kohën e tij”. Në Mekë, qeverisja dhe anëtarët e saj ishin politeistë, kurse myslimanët ishin në opozitë. Populli e urrente Islamin dhe myslimanët dhe i dëmtonte ata.

Qeverisja në Habeshe ishte jo myslimane, por ajo ishte e drejtë dhe i respektonte pakicat, përfshi këtu myslimanët, duke i siguruar atyre të drejta dhe liri.

Në Medine në etapën e parë qeveria ishte myslimane, por popullsia ishte e përzier, mes tyre Kishte çifutë, politeistë, paganë, hipokritë dhe myslimanë.

Në Medine në etapën e fundit, u pakësua kjo llojshmëri ku nuk mbeti asnjë nga politeistët, por mbetën shumë çifutë, bazuar në të dhënat e sakta të historisë.

Modeli i Mekës: Durimi dhe bashkëjetesa

Xha’fer bin Ebi Talib r.a. jep këtë panoramë për Mekën para islame në fjalën e tij të njohur

përpara Nexhashit: “O mbret, ishim një popull i paditur, adhuronim idhuj, hanim ngordhësirën, vepronim gjëra të turpshme, i bënim keq fqinjët dhe më i forti nga ne hante të dobëtin...” (Transmetoi Ahmedi)

Profeti (a.s.) pati bashkëjetuar me atë popull e me të keqen e tyre, duke vazhduar kryerjen e detyrave të tij – nëse më lejohet një përshkrim i tillë – në mesin e tyre. Këtë situatë e përshkruan Znj. Hatixhe, nëna e besimtarëve, e cila i drejtua atij: “Në asnjë mënyrë, përgëzo, se Allahu nuk të turpëron kurrën e kurrës, pasha Allahun ti do ta vësh nderin në vend, do mahnitësh bisedën, do mbartësh barrën, do fitosh mosekzistencën, do përforcosh të dobëtin e do stabilizosh e garantosh episodet e së vërtetës.” (Transmetoi Buhariu)

Profeti, paqja qoftë mbi të!, bëri aleancë me fiset e Kurejshëve, kur u zotuan në triumfin e padrejtësisë, i ftoi fiset në një aleancë në shtëpinë e Abdullah bin Xhud’an si ndër më fisnikët dhe aleanca u bë ndërmjet Benu Hashim, Benu El-Muttalib, Esedu bin Abdul-Uzej, Zehretu bin Kilab dhe Tejmu bin Mureh. Ata ranë dakort që askujt brenda Mekës të mos i bëhet padrejtësi, përndryshe ata do të bashkoheshin me të, deri sa personit t’i kthehej e drejta e tij. Këtë aleancë Kurejshët e quajtën “Aleanca e Mirësisë”.

Në lidhje me këtë Profeti ynë, paqja qoftë mbitë!, ka thënë: “Jam dëshmitar – në shtëpinë e Abdullah bin Xhud’an – i një aleance e cila ka qenë më e dashur për mua se ornamentet e deveve, dhe nëse do të ftohesha me të në Islam, do të përgjigjesha”. Profeti e ka mbajtur këtë aleancë edhe pas misionit, drejtonte me të e vepronte me përmbajtjen e saj deri sa atë e thyen Kurejshët.

Detyra jonë si myslimanë është që të jemi si i dërguari i Allahut, paqja qoftë mbi të!, nëse ndodhemi në një mjedis siç ishte ai në Mekë, të duruar e të bashkëjetojmë, pasi shumë thënie profetike e sigurojnë një gjë të tillë. Profeti duronte e bashkëjetonte dhe nuk i linte parimet, edhe pse mjedisi që e rrethonte atë nuk ishte i përshtatshëm.

Vëmë re se ata të cilët refuzuan bashkëjetesën e kuvendonin për persekutimin e myslimanëve ishin politeistët. I dërguari i Allahut, paqja qoftë mbi të!, vazhdonte të falej në Qabe në kohën që aty gjendeshin më shumë se treqind e gjashtëdhjetë idhuj. Megjithatë ai nuk u përpoq të shkatërronte asnjë idhull prej tyre, pavarësisht se ato

ishin kundër mesazhit të dëlirë me të cilin ai erdhi? Është detyra jonë që të thellohemi në përshkrimin e pozitës së të dërguarit të Allahut në Mekë e të deduktojmë nga çdo paragraf diçka që e ndihmon myslimanin të cilit i është caktuar të jetojë në një shoqëri që e urren Islamit dhe myslimanët.

Modeli habeshian: Besëlidhja e kooperimi

Në modelin e dytë në shoqërinë Habeshite për të cilën i dërguari i Allahut, paqja qoftë mbi tël, ka thënë pasiqë e pa dëmin që i kanosej bashkëkohësve të tij: "Sikur të dilnit në tokën e Habeshitëve, sepse atje është një mbret madhështor që nuk i bën padrejtësi askujt". Të parët që vajtën atje ishin: Osman bin Afani me bashkëshorten e tij Rukijë, vajzën e të dërguarit të Allahut, Zubejr bin Avvam, Abdurrahman bin Auf, Xha'fer bin Ebi Talib e shumë sahabë të tjerë. Profeti iu tha: "Derisa Allahu t'ju mundësojë juve rrugëzgjdhje e rrugëdalje..." (Transmetoi El-Bejhaki)

Fjala e Xha'fer bin Ebi Talib r.a. para Nexhashiut, është një fjalim elekuent, që ka nevojë për studime të gjata, ka nevojë që të deduktojmë prej saj dispozita që i sjellin dobi myslimanit në këto vende, në të cilat ekzistojnë qeveri të cilat nuk i kundërvihen Islamit, i ndihmojnë myslimanët e i duan ata si nënshetësit e tyre... Si veprojnë dhe si ndërveprojnë? Cili është koncepti i nënshetësisë? Madje edhe në kohën moderne ... të gjitha këto mund të merren nga eksperiencia e Habeshijve.

Modeli i Medines në etapën e parë: Çlirimi dhe bashkëpunimi

Nëse shkojmë në Medinen e Ndritur të asaj kohe do të gjejmë se ajo përbëhet nga çifutë, politeistë, hipokritë e myslimanë dhe në secilën prej këtyre shoqërive ka dispozita juridike të cilat nuk bien poshtë nëse nuk e lexojmë historinë dhe traditën e Profetit,

paqja qoftë mbi të. Do të veçoja diçka të bukur këtu dhe ajo është se në kohën kur Profeti, paqja qoftë mbi tël, emëroi Sa'd bin Muadh tek çifutët... ky është një sistem gjyqësor të cilin njerëzimi nuk e ka arritur ende në ditët e sotme dhe ky është të zgjedhë i akuzuari gjykatësin e tij. Duhet të dimë që ishte një vendim gjyqësor për krimin e tradhtisë së madhe.

Nuk mundet të klasifikohet për asgjësimin e një shoqërie e as për asgjësimin e një populli, por përkundrazi u ndërtua mbi sistemin e ligjit legjitim dhe marrëveshjeve me konsensus siç ishin në fletoren zyrtare të Medines.

Në këtë aspekt shohim se si ka qenë çështja e paqes për njerëzit e librit dhe kontradiktat e dijetarëve për të, dhe ka qenë Sufjan bin Ujejne dhe El-Evzaj e të tjerë në mbrojtje të paqes e kjo për një shkak e një qëllim: shmangien e ngatërresave, sepse ato duke ecur thonin "Es-Samu Alejkum" – "helmi mbi ju" d.m.th. shkatërrim për ju.

Ndërsa me hipokritët, mjafton që Allahu i Lartësuar e lejoi vrasjen e tyre megjithëkëtë Profeti nuk vrau asnjë prej tyre. Ai shprehej: "Mos të thonë njerëzit që Muhamedi vret bashkëkohësit e tij" (Transmetoi Buhariu). Ndërsa në suren Ahzabë thuhet: **"Nëse nuk i japin fund hipokritët e ata të cilët në zemrat e tyre kanë sëmundje dhe të njollosurit në Medine, do të provokojnë ty me to e më pas nuk do të afrohen më me përjashtim të një pakice. Të mallkuar, kudo që të jenë edukuar, u morën e u vranë barbarisht."** (Ahzabë, 60-61)

Ekziston një dallim ndërmjet lejimit dhe ekzekutimit, ndërmjet të lejuarës e të dhënës. Ky është një mësim që e mësojmë nga i Dërguari ynë, paqja qoftë mbi të. Nuk është e vërtetë absolutisht që Islami apo myslimanët njohin e pranojnë spastrimin etnik, njësimin e fesë, urrejtjen e njerëzve për të hyrë në fenë e tyre apo përzënie nga tokat e tyre... kjo nuk

ka ndodhur kurrë, as në kohën e Profetit dhe as në historinë e pastër islame.

Modeli i Medines në etapën e fundit: Drejtësia dhe vetëdija para përpjekjes

Modeli i katërt është ai i Medines në etapën e saj të fundit. Këtë e sqaron një thënie e Buhariut në të cilën thuhet: "Profeti ndërroi jetë dhe mburoja e tij ishte peng tek një çifut për tridhjetë Sa'a (masë matëse e barabartë afërsisht me 2.3 kg) elb".

U grindën një mysliman dhe një çifut, dhe myslimani thotë: Pasha Atë që zgjodhi Muhamedin nga të gjithë botët, ndërkohë që çifuti thotë: Pasha Atë që zgjodhi Musain nga të gjithë botët. Në këtë moment myslimani e qëllon me shuplakë çifutin. Çifuti shkon tek i dërguari i Allahut dhe e njofton për çfarë ndodhi mes tyre. Me këtë rast Profeti, paqja qoftë mbi të!, tha: "Mos më diferenconi në zgjedhje mua me Musain, sepse njerëzit ringrihen ditën e ringjalljes dhe do të jem i pari që do të ngrihem, e ndërkohë Musai është i shtrirë pranë fronit, dhe se nuk e di a është prej atyre që ringjallen e ngrihet para meje apo është nga ata që Allahu ka bërë përjashtim." (Transmeton Buhariu)

Ndërmjet Ta'meh bin Umejr nga myslimanët dhe Zejd bin Semijn nga çifutët ndodhi një ngatërrësë dhe i padrejti në këtë rast ishte myslimani, dhe për këtë zbriti thënia e të Lartësuarit: **"Mos debato për ata të cilët anojnë nga vetja e tyre, se vërtet Allahu nuk i do ata që janë arrogantë e mëkatarë"** (Nisa, 107). Këtu drejtësia e Profetit, paqja qoftë mbi të!, ishte në krahun e çifutit kundër myslimanit, sepse drejtësia është baza e posedimit dhe sepse Zoti dëshiron që të na nxjerrë neve nga errësira në dritë: **"Dhe mos ndërmerrni ndonjë ofensivë ndaj një populli e të bëni padrejtësi, bëni drejtësi sepse ajo është më afër devocionit."** (Maide, 8). Mësuam parimet, mësuam moralin dhe mësuam që sikur t'i hidhnin një sy të gjitha

botët do t'i besonin atij, paqja qoftë mbi të!

Profeti, paqja qoftë mbi të!, na mësoi durimin, na mësoi si të ndërveprojmë me njerëzit me butësi, duke mos imponuar tek ata mendimet dhe bindjet tona.

Profeti, paqja qoftë mbi të!, ka bashkëjetuar deri edhe me njerëzit më të këqij... Aishja r.a. tregon se një burrë i kërkoi leje Profetit dhe në momentin që e pa atë, ai tha: "Sa i keq është vëllai i klanit, sa i keq është biri i klanit". Kur personi në fjalë u largua, Aishja r.a. tha: O i dërguari i Allahut, në momentin që e pe burrin i the kështu e kështu. Kurse i dërguari i Allahut iu përgjigj: "O Aishe, kur më ke njohur mua kaq të pahijshëm, ndër njerëzit më të këqij në gradë tek Allahu ditën e ringjalljes është ai i cili i lejon njerëzit të vazhdojnë të qëndrojnë në të keqe." (Transmetoi Buhariu)

Çdo fjalë, sjellje apo veprim i Profetit, paqja qoftë mbi të!, përmban në vetvete rregulla, parime e metodika, të cilat mund t'i gjallërojmë në epokën tonë e mund t'i zbatojmë në realitet.

Është obligimi ynë që të studiojmë historinë, traditën e rrugën e të dërguarit të Allahut, paqja qoftë mbi të!, në të njëjtën koordinatë, të përpiqemi të deduktojmë prej tyre përbërës të personalitetit mysliman, për të kuptuar çështjet, përballjen e tij me botën, në jetesë, pjesëmarrje, mirëkuptim, bashkëpunim, adhurimin e Allahut, ndërtimin efikas në tokë dhe pastrimin e qenies humane, derisa të bëhet sikur e ka marrë Profetin, paqja qoftë mbi të!, si shembullin më të mirë, e derisa të realizojë besueshmërinë e nderin në pozitën e dëshmitarit mbi botët: **"Kështu pra ne ju bëjmë juve një komb të mesëm, në mënyrë që të jeni dëshmitarë mbi njerëzinë, e të jetë i Dërguari për ju dëshmitari absolut".**

Përktheu: Fatbardh Danja

Vlera e muajit Shaban dhe Nata e Beraetit



Në kalendarin Islam ndodhen disa data dhe muaj të shënuar, të cilave feja Islame u ka dhënë një rëndësi të veçantë. Ashtu sikundër jemi mësuar të dimë për muajin e Ramazanit dhe mirësitë e tij, po ashtu ka edhe data dhe muaj të shënuar që feja Islame u jep një rëndësi të veçantë.

Ndër muajt hënor kalendarik është dhe muaji Shaban i cili ndodhet dhe përkon gjithmonë para muajit të madhnueshëm të Ramazanit. Muaji shaban për ne myslimanët ka një rëndësi të veçantë për arsye se Profeti Muhamed (a.s.) i ka dhënë një rëndësi të veçantë dhe në këtë muaj kanë ndodhur ngjarje të cilat kanë vlerë për myslimanin.

Muaji Shaban na rikujton për disa momente të bukura historike që kanë përkuar me jetën e Profetit (a.s.) dhe shokëve të tij. Ndër momentet më të veçanta për këtë muaj është edhe zbritja e verseteve kuranore të cilat kanë të

bëjnë me ndryshimin e orientimit të drejtimit të faljes. Në fillimet e jetës fetare të myslimanëve dhe të Profetit (a.s.) në Medine ishte se gjithmonë kur kryheshin ritet e faljes, besimtarët orientoheshin kah Jeruzalemi dhe pikërisht në drejtim të Xhamisë Aksa. Një ditë prej ditësh Profeti (a.s.) ndërsa ishte duke u falur dhe duke qenë i drejtuar kah Jeruzalemi, menjëherë zbret ajeti kuranor ku Profeti (a.s.) urdhërohej të ndryshonte drejtimin e orientimit të tij falës duke e ndryshuar drejt Qabes tonë të madhërueshme.

Allahu thotë në Kur'anin Famëlartë duke na rikujtuar këtë moment të veçantë ku thotë: **"Të verejmë tek kthen fytyrën nga qielli. Ja, po të kthejmë nga kibla e dëshiruar. Ktheje fytyrën nga Faltorja e Shenjtë! Kudo që të jeni, kthejeni fytyrat nga ana e saj! Ta dinë ithtarët e Librit se ajo është e verteta nga Zoti i tyre. Zoti nuk është i shkujdesur**

ndaj veprave të tyre.” Ky ishte një moment historik për myslimanët, që në fakt na tregon se feja Islame erdhi për të korriguar dhe për të konfirmuar vazhdimësinë e Profetësisë pa dallim kombi dhe për të treguar universalitetin e mesazhit të cilin do të mbarte Profeti(a.s.)dhe myslimanët që do ta ndiqnin atë.

Prej gjërave të veçanta që e karakterizojnë këtë muaj dhe që i japin vlerë morale dhe lartësim shpirtëror është se në këtë muaj aktet dhe veprat e njeriut marrin tjetër kuptim të lartë. Profeti (a.s.) na thotë se ky muaj është një muaj në të cilin njerëzit dhe besimtarët janë të shkujdesur ndaj urdhëresave hyjnore.

Transmeton Usama ibn Zejd i cili tha: “E pyeta Profetin Muhamed (a.s.) duke i thënë se nuk të kam parë në asnjë muaj tjetër duke agjëruar më shumë sesa në muajin Shaban. Profeti (a.s.) i tha: “Shabani është një muaj në të cilin njerëzit janë të shkujdesur sepse është muaj i cili ndodhet ndërmjet Rexhepit dhe Ramazanit. Dhe ky është muaj në të cilin veprat ose aktet njerëzore ngjiten te Zoti – dhe dëshiroj që veprat e mija të ngjiten te Zoti teiksa jam agjërueshëm. (Transmeton Imam Ahmedi)

Po ashtu edhe në një trasmetim tjetër i cili përkon me të njëjtën logjikë me hadithin që thamë më sipër është kur Profeti (a.s.) tha: “Punët e mira ngjiten tek Zotit çdo ditë të enjte dhe të hëne, e në këtë ditë Allahu fal dhe mëshiron çdo besimtar i cili është agjërueshëm, përveç atyre që i bëjnë Zotit ortak duke mos e njësuar si të vetëm në adhurim dhe dedikim dhe po ashtu Allahu nuk fal ata besimtarë të cilët janë grindur me njëri-tjetrin dhe nuk janë pajtuar.”

Edhe në koleksionin e Imam Buhariut gjejmë të transmetuar veprat e Profetit (a.s.) që na e thotë nëna e besimtarëve Aishja (r.a), e cila thotë se kurrë nuk e kam parë të Dërguarin e Allahut (a.s.) të agjerojë gati pothuajse të gjithë muajin vetëm se në muajin Shaban. E gjithë kjo tablo transmetimesh na lë të kuptojmë për rëndësinë e muajit Shaban dhe vlerën e lartë që merr agjërimi dhe adhurimet e tjera te cilat duhen bërë.

E veçantë për këtë muaj është se në këtë muaj ka zbritur edhe një ajet tjetër kuranor i cili vlerëson pozitën e lartë që ka Profeti Muhamed (a.s.) dhe se çdo besimtar duhet me patjetër të përshëndesë dhe të çojë salavate për Profetin (a.s.). Allahu në Kur'anin Famëlartë thotë: **“Zoti dhe engjëjt e Tij e bekojnë Profetin as. Besimtarë, bekojeni dhe përshëndeteni atë me bindje!”**

Në këtë muaj ndodhet dhe një natë e cila quhet ndryshe dhe nata e gjysmës së muajit Shaban. Natë e cila ka vlera dhe vlerësim të madh nga Allahu i madhëruar dhe Profeti (a.s.).

Teksa mbajmë në mendje kuptimin e këtij ajeti kuranor, që na thotë se pavarësisht gjynaheve, duhet medoemos që të shpresojmë se Allahu xh. sh. me mëshirën e madhe që ka do të na i falë mëkatet dhe gjynahet që bëjmë me apo pa dashje gjatë jetës, punës apo tregtisë, le të kalojmë tek atmosfera e mëshirës që ka filluar të ndjehet tashmë në prag të ardhjes së muajit të Ramazani Sherifit, muaj gjatë

të cilit kjo mëshirë arrin nivelet më të larta dhe kulmon në Natën e madhe të Kadrit.

Kjo atmosferë mëshirë në prag të Ramazanit ka dy burime: burimi i parë është muaji i Shabanit dhe vlera e tij, dhe burimi i dytë është nata e mirë, Nata e Beraetit, ku mëshira e Allahut zbret mbi ne me bollëk të madh për të na falur mëkatet dhe për të na dhënë mbrothësi, begati, mbarësi e bereqet në jetën dhe punët tona. Kjo është nata që lidh të shtunën me të djelën, dhe që literaturën islame njihet me disa emra, të tillë si, nata e mesit të muajit Shaban, nata e faljes së mëkateve të vitit, nata e shkarkimit nga mëkatet, negativitetet dhe vështirësitë, nata e jetës së lumtur.

Për ata që janë të zotë të mendjes dhe që janë të interesuar, kjo natë është një ftesë që na bëhet për t'i bërë bilancin të kaluarës tonë, për të bërë një vlerësim të së tashmes dhe për ta projektuar të nesërmen sipas dëshirës dhe vullnetit të Allahut xh. sh. Nga kjo pikëpamje nata e mirë e Beraetit është një mundësi pendimi për mëkatet dhe gabimet tona të së shkuarës dhe një rreze shprese për një të ardhme më të mirë.

Ç'farë duhet të bëjmë ne si besimtarë me rastin e kësaj nate?

Natën le ta kalojmë me ibadet, kurse ditën me agjërim, përveç të tjerave është dhe synet i fortë të agjërosh tre ditët e bardha, që janë datat 13, 14 dhe 15 të çdo muaji.

Transmeton Ibn Maxheh prej Aliut r.a i cili tha: “Ka thënë Profeti (a.s.) se kur të jetë nata e gjysmës së Shabanit (nata e Beraetit) vleresojeni natën duke u ngritur për të falur dhe agjëroni ditën e saj, sepse Allahu zbret mëshirën e tij në qiellin e dynjasë, e thotë: “A ka në këtë kohë besimtarë që kërkojnë falje! A gjenden në këtë kohë besimtarë që kërkojnë pasuri! A gjenden njerëz të sëmurë që i luten Zotit për t'i shëruar! E kjo ndodh derisa të dalë agimi.”

Kjo natë është nata e faljes dhe e mëshirës. Resulullahu (a.s.) na mëson se në këtë natë Allahu e shton edhe më shumë mëshirën e tij mbi tokë dhe urdhëron e thotë: “A ka ndonjë që kërkon falje dhe unë ta fal? A ka ndonjë që kërkon rrizk dhe unë ta furnizoj me rrizk? A ka ndonjë që kërkon të shpëtojë prej vështirësive që unë t'i jap shpëtim?”

Edhe në një trasmetim tjetër të cilin na e sjell Imam Muslimi në koleksionin e tij prej Imran ibn Husejnit r.a se Profeti (a.s.) i ka thënë njërit prej sahabeve: “A agjërove mesin e Shabanit? Ai i thotë: jo Profeti tha: nëse e ke prishur agjërimin atëherë agjëro dy ditë më pas.”

Ndërkohë që ne rendim pas ëndërrimeve, dëshirave, punëve e halleve të kësaj dynjaje, po harrojmë se kush jemi, nga vijnë e ku shkojmë. Ne duhet një ndalesë, një pauzë, që të kujtohem se kush jemi në të vërtetë, cila është arsyeja që jemi krijuar, kush na ka krijuar, përse kemi ardhur në këtë botë. Kjo mënyrë e të menduarit merr akoma më shumë kuptim, pikërisht në këtë natë e cila ka një vlerë të madhe.

Eduard Shefkio

HISTORIA SE SI U BË MYSLIMAN AMR BIN ASI

Amr bin Asi (radjallahu anhu) ka thënë kështu: “Ditën që u kthyem nga beteja e Hendekut, i mblodha të gjithë ata kurejshë që i pranonin dhe i vlerësonin mendimet e mia, e që ma dëgjonin fjalën, dhe u thashë: “Uallahi, edhe ju e dini që unë po shoh se misioni i Muhamedit po përjeton një zhvillim të jashtëzakonshëm dhe sa vjen e po pranohet më shumë nga njerëzit. Unë kam një mendim, si thoni?”

- “Çfarë mendimi ke?”, – më pyetën ata.

- “Të shkojmë në Abisini, të kërkojmë strehim atje. Të qëndrojmë atje. Nëse ne jemi nën mbrojtjen Nexhaxhiut dhe Muhamedi e mund popullin tonë, atëherë do të jemi më mirë nën mbrojtjen e mbretit, se sa nën urdhrat e Muhamedit. Nëse fitimtar del populli ynë, ata na njohin dhe prej tyre neve nuk na vjen asnjë e keqe.”

- “Ky qenka një mendim me të vërtetë shumë i mirë!”, – thanë ata të gjithë njëzëri.

- “Atëherë filloni të mblidhni dhuratat të mëdha, që t’ia japim Nexhashiut, kur të na nxjerrin përpara tij.”

Dhurata më e mirë që ne mund t’i çonim nga trevat tona ishte lëkura e punuar. Mblodhëm shumë lëkurë dhe u nisëm, derisa, më në fund, udhëtimit tonë i erdhi fundi dhe ne mbërritëm te Nexhashiu. Kur ishim përballë tij, përpara na doli Amr bin Umejetu-Damriu, të cilin e kishin dërguar të interesohej për gjendjen e Ebu Xhaferit dhe shokëve të tij. Erdhi te Nexhashiu dhe pasi qëndroi i heshtur për pak çaste, doli. Unë u thashë shokëve të mi: “Ky është Amr bin Umejeja! Kur të dal përpara Nexhashiut, do t’i kërkoj që të ma japë mua dhe unë do ta marr e do ta vras. Po e bëra këtë, kurejshët do të më përgëzojnë, e do të më quajnë se kam vrasur lajmësin e Muhamedit.”

Dola përpara Nexhashiut dhe ashtu siç kisha bërë përherë, iu përula në sexhde. Nexhashiu më priti, duke më thënë:

- “Mirë se erdhe, miku im! A më ke sjellë ndonjë dhuratë

nga vendi juaj?”

- “Po, o sundimtar! Të kam prurë shumë lëkurë të mira.”, – iu përgjigja unë dhe ia shtrova lëkurët përpara këmbëve. Dukej që i pëlqyen shumë dhe mbeti menjëherë shumë i kënaqur.

- “O mbret! Pashë një burrë që ishte këtu pak më parë. Ai është lajmësi i armikut tonë. Ma jep mua ta vras; ai ka vrasur e ka dëmtuar shumë prej njerëzve më të nderuar në radhët tona.”

Nexhashiu u nxeh. Sikur të ishte çarë toka në mes e të isha futur në dhe më mirë, se sa të më pushtonte gjithë ajo frikë që ma pushtoi zemrën. Pastaj, për ta zbutur, i thashë: “O sundimtar, për Zotin, po ta dila se kjo kërkesë imja do të të mërziste kaq shumë, nuk do të ta kisha kërkuar!”

- “Domethënë ti kërkon lejen time për të vrasur kasnecin e një njeriu, të cilit i ka ardhur Zbritësi i Shpalljes (Xhibrili), ai që dikur i pat ardhur edhe Musait?”

- “Imzot, pse një njeri i atillë është ai?”, – e pyeta unë.

- “Turp të kesh, o Amr! Më dëgjo mua dhe bindju atij njeriu. Uallahi ai është në të drejtë. Ai ka për të dalë fitimtar mbi armiqtë e tij, njësoj siç Musa bin Imrani doli fitimtar kundër faraonit dhe gjithë ushtrive të tij!”, – tha Nexhashiu.

- “A e pranon ndërmjetësinë time, nëse unë e lidh besën me ty në emër të tij?”, – e pyeta unë

- “Po, e pranoj.”, – m’u përgjig ai.

Zgjati dorën dhe unë pranova Islamin. Pastaj, kur u ktheva te shokët e mi, patjetër që kisha hequr dorë nga mendimi me të cilin kisha hyrë te Nexhashiu; megjithatë ua mbajta të fshehtë që isha bërë mysliman. Dhe, kësaj, u largova nga Abisinia, për të shkuar tek i Dërguari i Allahut. Në rrugë takova Halid bin Uelidin. Ishte pak kohë para se të ndodhte ngadhënjimi i Mekës. Halidi po vinte nga Meka. I thashë:

- “Për ku je nisur kështu, o Ebu Sulejman?”

- “Uallahi, fitimtar doli ai (duke pasur parasysh Profetin



tonë). Ai është vërtet profet i Zotit! Tani po shkoj për tek ai. Do të bëhem mysliman! Deri kur do të vazhdojë kështu kjo luftë?"

- "Uallahi, edhe unë nuk kam ndonjë qëllim tjetër, pasi edhe unë kam ardhur të bëhem mysliman.", - i thashë unë.

Shkuam në Medinë, pranë Profetit të nderuar. I pari hyri Halidi dhe pranoi Islamin. Pastaj u afrova unë dhe i thashë:

- "O Resulullah, unë do ta lidh besën me ty, vetëm nëse do të m'i falësh të gjitha gabimet e së shkuarës. Të mos i them që tani mëkatet që do të bëj në të ardhmen."

I Dërguari i Allahut (sal'lallahu alejhi ue sel'lem), i cili e dëgjoi kërkesën time, tha: - "Eja, o Amr, bindu, sepse Islami i fshin të gjithë mëkatet e kryera para ardhjes së tij. Mërgimi i fshin edhe më shpejt të gjitha të këqijat e njeriut."

Kështu, unë iu binda, pranova Islamin dhe u ktheva andej nga kisha ardhur."

Mjaft interesante janë edhe hollësitë e përshkuara në transmetimin e Bejhakiut, i cili na vjen nëpërmjet Uakidiut:

"... (Amr bin Asi thotë se:) Pastaj unë vijova rrugën. Kur mbërrita në vendin e quajtur Hidde, që gjendej diku mes Taifit dhe Mekës; jo shumë kohë, por pak përpara meje, aty kishin ardhur dy burra, të cilët ishin duke hyrë në çadër. Njëri qëndronte brenda çadrës, ndërsa tjetri jashtë, mbante edhe dy kafshët e rrugës. Pashë njëherë, ishte Halid bin Uelidi.

- "Për ku je nisur kështu?", - e pyeta.

- "Për te Muhamedi po shkoj. Nuk mbeti më njeri me mend në kokë pa hyrë në Islam. Uallahi, mendoj se po u vonova edhe pak, edhe ne kanë për të na kapur për zverku, ashtu siç kapen hienat!", - m'u përgjigj.

- "Uallahi, edhe unë për te Muhamedi jam nisur, kam vendosur të bëhem mysliman.", - i thashë.

Pashë njëherë, nga çadra doli Osman bin Talhaja, i cili më tha: - "Mirë se erdhe!" Aty qëndruam të tre, duke u marrë

vesh se do ta bënim bashkë pjesën e mbetur të rrugës deri në Medinë. Kur iu afruam pusit të Ebu Utbes, nuk e harroj që dëgjova një burrë që thërriste: "O Rebbah! O Rebbah!" Na u dukën si ogur ato fjalë të atij njeriu, të cilat kishin kuptimin e "fitimit" dhe vazhduam rrugën. Pastaj pamë se ai burrë po shihte nga ne dhe ma merr mendja se e kishte me Halidin kur mëmërishte:

- "Përderisa po e pranojnë edhe këta të dy Islamin, kjo do të thotë se Meka i dorëzoi përfundimisht çelësat e saj."

Ai burrë filloi të rendte dhe shkoi drejt e në faltore. Ma merr mendja se po lajmëronte të Dërguarin e Allahut për ardhjen tonë. Dhe ashtu siç pandeha unë edhe ndodhi. I ulëm devetë në gjuhë në vendin e quajtur Harre dhe u veshëm me rrobat tona më të mira. Pak më vonë u këndua ezani i ikindisë. Shkuam tek i Dërguari i Allahut. Fytyra i shndriste ashtu siç shndrin hëna e plotë. Të gjithë myslimanët kishin krijuar një hallkë të bukur rreth tij. Ishin shumë të lumtur, që ne kishim pranuar Islamin. I pari hyri Halid bin Uelidi, i cili shprehu se andej e tutje kishte pranuar Islamin. Pas tij u afrua Osman bin Talhaja dhe pas tij hyra unë. Uallahi, nga turpi, kur iu ula përballë, nuk i ngrija dot sytë që ta shihja në fytyrë. Nuk më shkoi mendja që t'ia thosha mëkatet që do të bëja në të ardhmen. Por ai më tha: "Islami i pastron e i fshin të gjitha mëkatet e kryera përpara tij, ndërsa mërgimi i fshin të gjitha gabimet e së shkuarës."

Ju betohem në Allahun, se që nga ai çast që u bëmë myslimanë, Resulullahu nuk ka mbajtur kurrë asnjë sahab tjetër të tij më lart se ne, në çdo çështje që për të ishte e rëndësishme."

Shkëputur nga libri "Jeta e Sahabëve 1"
M. Jusuf Kandeheui
Botim i KMSH

Të rinjt e sotshëm SI MEJTOJNË EDHE KUJT I MBESOJNË

Nji pyetje kjo aq me randesi sa munda të themi pa druajtësi fare se përgjegjëja e sajë mertonë studime të thella, dhe ka hijë me të vërtet me qenë landa shkrimore e ç'është Rivistë qi ka për program mbarsin e njerzisë ashtu edhe udhëheqjen morale.

Nji pyetje kjo qi ka tërhequn mbas vedi mendimin e gjith Botës, dhe qi përfundimi i përgjegjës do të na tregojë se shekulli i sotshëm me të rinjet e vetë cilli pritmë i asht drejtue tue i hedhun mrapa ç'ka ka gjetun si themele morali e besimi.

Po kalojnë do kohra qi n'Amerikë e Sosjeteja e krishterve të rinjë po vazhdon në ankete mbi ketë pyetje, dhe po mbledh përgjegjët për me kuptuëm sot si mejtojnë e kujt i mbesojnë të rinjët. Për fat të keqë përfundimi i këtyre studimeve po na jep të kuptojmë se të rinjet e sotshëm ma nuk po i mbesojnë Fesë,

dhe në Amerikë e Ingjilterë ku shquheshin njerëzia me respektimin krishterizmës sot të rinjet po thonë nuk i mbesojnë Zotit e se Feja e sotshëm nuk asht e mundun të na përuhin ndjenja e mendimet me bazat e saja të gabueshme.

Kjo duhije kundreshtimi ka pushtuarë Europën dhe asht hedhun në Asijë, po thuë se në mëndjen e gjith të rinjitet asht bamun nji hije e pa ndame. Tash mujin e fundit edhe Rivista e shquëme e Turqisë "Sevimli aj", i bante nji anqet mbi të rinjët e Trugisë dhe ndërmjetësonte me kuptuëm rezultatin për sa i përket vendit të vetë. Mbas evolucionit të madhë qi bani Turqija asht e ditun qit ë rinjët e s'ajë nuk do të japin nji mendim të kundërtë me ato të Amerikës, nuk do të mejtojnë tjetër llojë nga ata t'Europës qi po imitojnë tue marrë për shëmbëll të mirat e të ligat tokë.

Sa për të rinjët t'onë ktu në Shqipni nuk duhet të vrasim mendjen edhe aqi shumë se pjesa e këtyne qi po marrin mësimin n'Europë natyrisht po hiqen prapa atij rrymi qi ka marrë ky qytetnim dhe kanë me dalun në atë breg të çuditshëm qi po prapulizet i tanë rruzelemi.

Nji kryengritje mendimi asht tue pushtue me avullin e flakën e s'aje të gjithë të rinjet të cillët duanë t'i këputin marëdhanëjet qi kanë me tradicionet e kohrave të kaluесе; të cillat nuk pëlqejnë Fenë, rregullat sociale, lidhjet morale. Në shekujt e kaluem shumë herë ka ndodhun qi njerëzia e pushtuarë nga mëshypjet natyrale ka arritun në harresën e Fev'e të zakoneve; por shekulli i sotshëm që numërohet ma i përparuem se të tjerët nuk duket të ngeli prap i metë para shekujve qi kanë me ardhur.

Midis faktorëve kryesuër qi kanë shtytur të rinjet e sotshëm me këtë bindje lufta e Përgjijëshme, dhe mbas kësajë kurentet e çuditshëm të komunizmës e të Fashizmës. Me të vërtetë nga mjerimet e luftës tue lindun komunizma me tjetër anë si shëmbllë gjallënie kundra saj ringrefja e Fashizmës i shkaktoj krye-këputë mejtimet e të rinjëvet. Për këta sot nuk ka ngelun nji fuqijë shpirtnore të tërheqin mbas vedi, nuk ka ngelun nji streh adhurimi qi ti përmbeldhim në gjinin e vetë të pastër. Këta ankohen nga jeta e sotshme sociale moralë e Fetare, por nuk janë të zotnit të kujtojnë nji bazë të sakët për udhëheqjen e tyne landore e shpirtënore.

Nuk mjaftojnë qeshja e tyne me konsideratat e moralit të vjetër, nuk siguron lumtunië liria e pakufizuese qi dëshrojnë të kenë për me rojtun pa kur fare pengese të rinj e të reja tokë tue mos qënë mbi krye si nji mprojtës i mirësjellimit Mëma, Ata, Feja dhe Faltorja.

Nuk duhet të harrojmë se qytetënimimi bazën e vetë e ka pështetun në jetën familjare dhe kjo jetën e çmuarë me raca e fize të tjera. Këto i dinë të rinjet, dhe prandaj ankohen nga jeta tue mos ditun cilës ideë kanë me u pështetun; kta janë bamun kret materialist dhe nuk mejtojnë tjetër gja, veç se me fitua të holla, m'u bamë pasanik me rrojtun në nji jetë plotë qetije e zbvajtje. Para syve të riut të sotshëm ma i madhi njeri në botë është Krali i Automobilave: Fordi, ma i vlefshmi Libër asht Romani i dashunisë.

Pra po e shohim çiltazi se në jetën e mbrendëshme kemi nji shkretëie të përgjithshme; as nji gja nuk na bindë dëshirat as kur sendi nuk kënaqë; si nji detë qi përplasat nga shtërgata asht tue lloçkitë tue u tramzue mendimi i brezit të rijë dhe po mundohet me gjetun shtroherën qit ë prekin pakë ndijësit e ashpëruara.

Po vallë ku dhe kur?...

Këta për m'e gjetun duhet t'a dimë ku jemi tue shkuë? Profidet të rinjë e të rremë a kanë me qenë të zotnit si ata të vërtetët qit ë shpëtojnë njëzimin nga nji shkatërrim i tillë? Neve jemi sigur qi shpirti në pikëpamjen fetare inspiracionet e vetë i shfaqi sa duhet në faqe të dheut, porosit e tij aqi të nalta janë të

mjaftëushme për mbarëvajtjen e jetës sociale e morale; por mjaftojnë qi njeriu tue përparuem mos të harronjë përfitimin e vlefshim t'asajë fuqije shpirtënore.

Fuqia jetike e madhështore në gjithsi asht po thuë si mëndja në trup të njeriut; po ngrite mëndjen sa parë vlënë njeriu; shpirti ndaj fuqisë jetike asht si syni kundrejt mëndjes; po të mos ishte drita e synit si të tregonte vehtë mëndja?...

Me pakë fjalë duam të themi se mbesimi kundrejt Zotit asht i domosdoshëm për njerinë; shpirti sa do qi nuk shifet, por me shfaqësina e tij të përhershme na detyron mos t'a mohojmë; në nji Trioletë shpirtënore qi kemi shtypun në "Gjimimin e Tomorrit" kemi pas thanë:

Ku ke qenë e bukur lule;

Me këtë erë pa të metë;

As më thuaj mos je flutur

Flutur e jetës së vërtetë;

Si le?

Shoqet në Foletë

Si u ndave nga ajo Jetë?

Për të treguar nji shëmbëll se si ndohet shpirti në trup të njeriut ma posht kishim thanë:

Si pasqyra në Dhom' t'errët,

Qi s'tregon gja sendi brenda,

Të ka mbytur krejt ënda;

Si përlante mu në lerat;

Të është veshurë fytyra;


Nuk shkëlqen më si nga hera;

Je në Dimër të la vera!

Dhe me të vërtetë kur hedhim vështrime studjuëse mbi jetën e kaluemë të njeriut takojmë shumë herë në kundërshtim me çështjen e ekzistencës të shpirtit. Por nuk duhet harruë sa ma të lumnushim në këtë jetë kanë qenë e janë ato njerëz qi përpara universeri t'ambjentit – janë të pështetun në shtyllën e besimit (Le fondement de la foi). Hafezi Shirazi ka pasë thanë:

Në këshillën e zëmres nga shkëlqimi i fytyrës t'ande u ndezën nji qind drita; Çudija asht këtu qi në fytyrën t'ande ndodhën nji qind llojë napash (perde); dhe me të vërtetë njeriu pa dashun të kuptonji ç'asht mëndja ose tue mos kuptua nga cili burim i ka ardhur drita e tij nuk asht i zoti të shofin dritën e Zotit, e cila në naturë shfaqet në trajta të provimeve të përtrishme e të njifarshim (epperiences sepetes et homogens), por nuk duhet të harrojmë edhe mendimet e të mdhanjvet mendjetar si De Karti e Malbranshi qi thonë në gjithsinë materiale shkaqet e ndodhinave e të ngjarjeve janë Occasionnelles – ndermjetore për ditjen e Krijuesit qi asht i vetmi urdhnuës i vërtetë. Malbranshi ksodore ka pranue përfundisht theorin "La vision en dieu" vështrim në Perendinë qit ë cilës Tasavufi Islamikë i ka thanë:

Nuk pashë as nji gja, qi të mos shofë Perëndinë në atë.



FAIK KASOLLJA
(1930-2019)

Më datë 12 shkurt 2019 pushoi së rrahuri zemra e profesorit dhe studiuesit Faik Kasollja. Lajmi ishte i dhimbshëm për të gjithë myslimanët shqiptarë, në veçanti ata të kryeqytetit, pasi jeta e tij është e lidhur me historinë e gazetarisë dhe publicistikën islame në Shqipëri, dhe njëherësh është monument në çdo fushë të aktivitetit dhe dinjitetit njerëzor të një njeriu që lindi, u rrit, punoi, kërkoi dhe jetoi vetëm për të vërtetën dhe sakrificoi shumë për të.

Vitet e jetës së tij ecnin dhe kaluan, bardhësia i mbuloi kokën, pleqëria i erdhi, por nuk e mposhtën dot, sepse Fuqia e Allahut xh.sh. e rinonte gjithmonë që të ecte përpara në rrugën e shenjtë të shërbimit ndaj fesë, kombit dhe shoqërisë. Zoti i dhuroi virtutet më të larta, cilësi këto që do të dëshironte t'i kishte çdo njeri. Veprimtaria e tij është shumëplanëshe. Ajo nuk është veprimtari e thjeshtë e një gazetari që shkroi e kontribuoi në organet islame të kohës, si "Drita islame", "Drita e Kur'anit", "Univers" etj., apo e një publicisti kalimtar, por e një përfaqësuesi të denjë i fushave arsimore e kulturore, e një njeriu besnik ndaj atdheut, kombit e shoqërisë, që foli çdo rast me krenari.

Kush ishte Faik Kasollja?

Faik Ali Kasollja lindi në Petrelë më 21 dhjetor 1930. Shkollën fillore e kreu në vendlindje, ndërsa njohuritë e para të fesë islame i mori nga i ati në shtëpi. Më pas ishte dëshira e të atit për ta

dërguar në Medrese, të cilën e mbaroi në qershor të vitit 1951 dhe mori maturën shtetërore me një diplomë, ku dolën njëmbëdhjetë maturantë. Pa vonësë u emërua imam i xhamisë së Mulletit me emrin e Sulltan Fatihut.

Pas një viti rekrutohet ushtar. Pas shërbimit ushtarak, akoma pa u kthyer në shtëpi, e kishin emëruar mësues në shkollën fillore të fshatit Pashkashesh pa asnjë lloj kërkese, të cilën nuk e kundërshtoi edhe për shkaqe ekonomike.

Me qëllim për të vazhduar studimet e larta, u regjistrua në Shkollën Pedagogjike të Tiranës dhe brenda vitit mori maturën. Më pas regjistrohet për studimet e larta në degën Histori-Filologji me korrespondencë. Gjatë kësaj kohe kaloi sa në një shkollë të zonës së Petrelës në tjetrën nëpër fshatrat: Mihajas, Mushqeta, Shënkoll, më vonë në shkollën tetëvjeçare të Mulletit ku vijoi dhjetë vjet e më në fund përfundoi në Petrelë, ku doli në pension.

Si mësues dallohet për një menaxhim efektiv dhe në mënyrë të organizuar të orëve mësimore, për një nivel të lartë të mësimdhënies. Gjatë punës në arsim u identifikua si personalitet i përsosur i njeriut të ndershëm, të ditur dhe të ngritur, me imagjinatë, ndjeshmëri, intuitë dhe vizion. Punoi vazhdimisht për ngritjen e tij profesionale, shkencore, pedagogjike, të strategjisë së mësimdhënies, planifikimit dhe zhvillimit të mësimin, ku arriti rezultate të larta.

Pas rënies së komunizmit dhe shpalljes së demokracisë në vendin tonë, nga fillimi i vitit 1991 nisi takime së bashku me të tjerë, për rihapjen e xhamisë së Haxhi Et'hem Beut. Ngjarjet rrodhën në favor të aktiviteteve të tjera.

U hodhën hapat e para përgatitore për nisjen dhe botimin e gazetës "Drita islame". Kryeredaktor i gazetës u caktua Ismail Muçej dhe numri i parë i saj doli në janar 1992. Në redaksinë e gazetës Faiku punonte së bashku me shokë të tjerë.

Ka botuar shkrime në shtypin islam, "Drita islame", "Drita e Ehlibejtit", "Këshilla", "Drita e Kur'anit", si dhe në organet e shtypit publik si të "Mësuesi", "Republika", etj. Është botues i disa librave, si:

1. Hafiz Ali Korça - Poet e atdhetar, botuar nga Albanian Islamic Center Harper Woods Mich. U.S.A, 1995.

2. Në pragun e misticizmit, Tiranë, 2002.

3. Bibliografia e revistave Zani i Naltë, Kultura Islame, Njeriu, Botimet ALSAR, Istanbul, 2007; bibliografia e gazetës Drita islame, 2015.

Botime në shtypin publik:

Misticizmi në Islam dhe disa përfaqësues (Revista "Universi", nr. 8, viti 2006).

Hafiz Ismet Dibra - teologu, atdhetari, mësuesi ("A ka dyshim në qenien e Zotit?" Fondacioni i Kur'anit, Tiranë, 2007).

Hafiz Ibrahim Dalliu - figurë poliedrike kombëtare (Ajka e kuptimeve të Kur'anit, Tiranë, 2005).

Në shoqëri me vargjet e Sheh Ahmed Shkodrës (Gazeta "Drita e dijes", Shkodër, gusht 2002).

Hafiz Ibrahim Dalliu, përfaqësuesi i brezit të fundit të rilindësve (Gazeta "Republika", Tiranë, 18 gusht 2010).

Shtypi patriotik i pavarur në Tiranën e viteve 1924-1926 nën emrin e gazetës "Dajti" (Gazeta "Republika", e enjte, 16 dhjetor 2010).

Banorët e Petrelës nuk e harrojnë mësuesen e tyre, Zybejta Qereshniku (Gazeta "Mësuesi", 1 mars 2006).

Imazhe shqiptare përtej oqeanit (kushtuar 50-vjetorit të veprimtarisë së Vehbi Ismailit, në Qendrën Islame shqiptare të Detroitit, të Sh.B.A., gazeta "Republika", 17 maj 2009).

Për pesë vite me radhë ka qenë kryeredaktor i gazetës "Drita e Ehlibejtit", ku ka shkruar vetë dhe është autor i mbi 125 shkrimeve. Ka punuar edhe në Medresenë e Tiranës si mësues e më pas si sekretar i kësaj shkolle, ku dallohet për korrektësinë e tij në zbatimin e rregullores së shkollës.

Prof. Faiku ishte shumë i njohur në masën e besimtarëve për kontributin e tij të madh në pasurimin dhe zhvillimin e shtypit islam shqiptar. Ishte figurë e pastër morale, i nderuar e i respektuar dhe shumë i dashur e i komunikueshëm në shoqëri.

Faik Kasollja përbente një pasuri intelektuale.

Si të qëndrojmë larg gjynaheve (Sedd-I Dherrâi)

Besimtarët janë të bindur se punët dhe veprat e tyre shënohen nga Melaiket shënues, Kiramen Katibinët.

Allahu i Lartësuar në Kuranin Fisnik thotë kështu: **“Ndonëse mbi ju ka rojtarë (që ju vëzhgojnë), shënues të nderuar, që dinë gjithçka që bëni. (Infitar 10-12).**

Çdo punë që bën njeriu, qoftë edhe e vogël sa një grimcë atomi, këto melaiket e shënojnë në fletorën e veprave, e cila do të paraqitet përpara nesh ditën e gjykimit si argument pro apo kundër.

Allahu i Lartësuar thotë: **“Kush ka bërë ndonjë të mirë, qoftë sa një thërmijë, do ta shohë atë, e kush ka bërë ndonjë të keqe, qoftë sa një thërmijë, do ta shohë atë. (Zelzele 7-8)**

Këto melaiket shënojnë atë çfarë njeriu vepron në të jashtmen e tij, mirëpo ata kurrsesi nuk e dinë atë çfarë njeriu ka në zemrën e tij. Prandaj gjykimi përfundimtar i veprës tonë i mbetet vetëm Allahut të Lartësuar. Ai di qëllimet dhe njuh sekretet e zemrave tona. Njeriu është gabimtarë dhe kjo është botërisht e ditur. Nuk ka asnjë njeri pa gabime dhe gjynahe. Perfekt dhe pa të meta është vetëm Krijuesi i botëve.

Në lidhje me këtë i Dërguari i Allahut (a.s) thotë: “Ademi (a.s) gaboi, po ashtu gabuan dhe bijtë e tij, Ademi (a.s) harroi, po ashtu harruan fëmijet e tij. (Tirmidhiu).

Gjëja më e rëndësishme mbas gabimit me dashje apo harresë është pendimi me sinqeritet kundrejt Allahut të Lartësuar, sepse në këtë formë njeriu fiton një cilësi të mirë dhe bëhet prej njerëzve të cilët zotërojnë cilësi dhe virtyte të mira, siç është ajo e kërkimit të faljes.

Thotë i Dërguari i Allahut (a.s): “Çdo bir i Ademit është gabimtar, por më i mirë i gabimtarëve është ai i cili pendohet.” (Tirmidhiu, Ibn Maxhe)

Njeriu çdo gabim që bën duhet ta pasojë me pendim dhe kërkim-falje (teube, istigfar), për vetë faktin sepse është një prej cilësive më të dashura të Zotit.

Allahu i Lartësuar në Kuranin Fisnik na mëson që njeriu duhet ti kërkojë falje Zotit për gjynahet dhe gabimet e tij, qofshin këto me dashje apo jo, me vetëdije apo në harresë. Për këtë arsye në Kuran, përmendet lutja: **“Zoti ynë mos na ndëshko për atë që harrojmë ose veprojmë pa qëllim”. (Bakare, 286).**

Kur njeriu këshillohet që të kërkojë falje për gjërat të cilat ai ka vepruar pa dashje ose në harresë, atëherë nga kjo kuptohet se sa e rëndësishme është dhe sa shumë duhet që njeriu të kërkojë falje dhe të pendohet për gjërat të cilat i vepron me vetëdije. Prandaj ruajtja nga gjynahet duhet të jetë qëllimi dhe preokupimi më i rëndësishëm në jetën e besimtarit.

Duhet që besimtari të mbrojë zemrën e tij nga gjynahet, sepse në këtë formë ai mbron besimin, nderin, moralin dhe dinjitetin e tij.

Në të kundërtën, njeriu do të rrezikonte shumë besimin e tij, sepse siç dhe thuhet nga dijetarë të shumtë; “Çdo gjynah është një rrugë për në mosbesim”.

Këtë na e pasqyron i Dërguari i Allahut (a.s) ku thotë: “Kur robi vepron një gjynah, vendoset në zemrën e tij një pikë e zezë. Në momentin që ky njeri pendohet, atëherë kjo pikë e zezë fshihet dhe pastrohet.”

Nëse ai përsëri vepron gjynah dhe është i vazhdueshëm në të, kjo pikë e zezë sa vjen dhe zmadhohet në zemrën e tij dhe e kaplon të gjithë atë. Më pas i dërguari i Allahut (a.s) shton dhe thotë: "Pikërisht për këtë gjë Allahu i Lartësuar thotë në Kuran **"Nuk është ashtu! Por veprat e tyre (të këqija) ua kanë mbuluar zemrat."** (Mutaffifin 14)

(Transmeton Ibn Xherir Taberiu në tefsirin e tij)

Sedd-i dherrâii (عوارذلا دس) është një terminologji e përdorur në literaturën islame (Në usulu fikh të imam Ahmedit dhe Malikut), e cila do të thotë të vendosësh pengesa për gjynahet dhe për të arritur tek diçka më e mirë.

Kjo për vetë faktin sepse Allahu i Lartësuar në Kur'anin fisnik përdor termin "Ue le tekrrabu" -dhe mos ju afro gjynahut (Enam 152, Isra 32).

Kjo bën atë që një mysliman duhet që ti peshojë gjërat në bazë të asaj çfarë thotë feja e Zotit.

Merret situata dhe filtrohet sipas ligjeve islame. Nuk filtrohen ligjet e Kur'anit në bazë të situatës, nuk përshtatet Kur'ani sipas situatës, por situata duhet të dali në konkluzionin përfundimtar sipas Kuranit.

Prandaj kur dikush përballet me një vepër e cila është haram, ai nuk ka aspak mëdyshje nga mënjanimi i saj, sepse është plotësisht i bindur se ai gjynah mund të bëhet shkak për zemërimin e Zotit, por dhe nga ana tjetër është plotësisht i bindur se largimi nga ai gjynah mund të bëhet shkak për kënaqësinë e Zotit, ku si shpërblim arrin gradë të lartë në dynja dhe ahiret.

Që të mos arrihet tek gjynahu, atëherë mund të ketë disa veprime parandaluese të cilat e mbrojnë besimtarin që të mos përfundojë në veprim të diçkaje të gabuar.

Mund të sjellim si shembull historinë më të bukur të cilësuar nga Kur'ani Fisnik, atë të Jusufit (a.s);

-Ai në momentin që u përball me gjynahun menjëherë kujtoi mirësitë e Zotit të Tij, ku në fakt të kujtosh mirësitë e Zotit tënd në momentet drejt gjynahut, mund të bëhet një "Sedd-i dherrâii".

Duke qënë afër për të rënë në gjynah, situatën dhe reagiminin e Jusufit (a.s) Kur'ani e shpjegon kështu: **"Por ajo, në shtëpinë e së cilës gjendej ai, nisi ta joshë në kundërshtim me dëshirën e tij. Ajo ia mbylli të gjitha dyert dhe tha: "Jam e gatshme për ty!" Kurse ai tha: "Allahu më ruajt! Me të vërtetë, Zoti im ka treguar kujdes për mua dhe, pa dyshim, keqbërësit nuk do të shpëtojnë kurrë".(Jusuf: 23)**

Jusufi (a.s) jo vetëm këtë që pati këtë reagim, por ai do të kënaqej edhe sikur të burgosej për vite të tëra, por kurrsesi ai mos të binte në një gjynah të tillë. Ai tha: **"O Zoti im, më shumë e dua burgun se atë ku më shtynjë ato. Nëse Ti nuk e largon prej meje dredhinë e tyre, unë do të prirem drejt atyre dhe do të bëhem nga ata që nuk (i) dinë (ligjet e Tua)."** (Jusuf: 33)

Pikë tjetër që duhet të kemi kujdes ndaj gjynaheve është dhe qëndrimi larg atmosferës së gjynaheve.

Allahu i Lartësuar thotë kështu: "Dhe mos i'u qasni zinasë, se ajo është shfrenim dhe rrugë e shëmtuar! (Israa: 32).

Pra, qëndro larg çdo dere e cila nëse do të hapet, mbas saj qëndron një humnerë, ku nëse bie do të rrezikosh besimin

tënd dhe ahiretin tënd.

Të qëndrosh afër gjynahut do të thotë që herët a vonë do e veprësh atë.

Prandaj këshillon Allahu i Lartësuar në këtë formë, sepse Ai është Krijuesi ynë dhe kush më mirë se Ai e njeh krijesën e Tij.

-Një pikë tjetër pengesë për gjynahet është shoqërimi me njerëz të mirë, besimtarë.

I dërguari I Allahut a.s këshillon që kur dikush prej jush udhëton, atëherë minimumi të jenë tre veta, sepse në këtë formë mund të bëhen pengesë ndaj njëri-tjetrit për mos të rënë në gjynahe. (Ebu Davud, Tirmidhiu).

-Të shfrytëzosh mirësitë e hallallit në kohën e duhur është një pengesë tjetër për gjynahet. P.sh njeriu e ka hallall të martohet në moshë të re, kur ai i plotëson kushtet e nevojshme, mirëpo nëse ai këtë gjë nuk e aplikon dhe e vonon, atëherë ai është shumë më i ekspozuar drejt nefsit dhe shejtanit të mallkuar që të përdorin epshet e tij dhe kësisoj të përfundojë në gjynah.

Në këtë formë besimtari ruan zemrën e tij nga gjynahet, ku duke ruajtur zemrën ruan besimin e tij.

Punët e zemrës janë një prej punëve aq sa delikate, por aq dhe të rëndësishme për të pasur sukses në të dy botët.

Prandaj nga lutjet më të shpeshta në përditshmërinë e Muhamedit (a.s.) ishte: "O Forcuesi i zemrave ma forco zemrën time në fenë tënde".

Kur Aishja (r.a) e pyet të dërguarin e Allahut se pse ai e thotë kaq shpesh këtë lutje, Ai (s.a.s) përgjigjet: "pa diskutim që zemra e njeriut është midis "dy gishtave të Allahut", kë do Ai e bën që të devijojë dhe kë do Ai e forcon". (Musnedi i imam Ahmedit)

Allahu i Lartësuar në Kur'anin Fisnik shpeshherë na mëson lutjet specifike, të cilat në fakt sipas shumë dijetarëve janë lutjet me potencialin më të madh për t'u pranuar. Në të njëjtën kohë janë lutjet të cilat plotësojnë të gjitha nevojat e njeriut qoftë të dynjasë qoftë dhe të ahiretit. Duke u lutur me lutjet që Allahu na mëson në Kuran, atëherë do të thotë se i je bindur Zotit tënd i Cili sikur thotë kështu: "lutu me lutjen që Unë të mësoj, sepse jam Unë Ai i Cili të njoh ty më mirë sesa ti njeh vetveten tënde". Nisur nga kjo Ai na mëson të lutemi kështu: (Ata thonë:) **"O Zoti ynë! Mos lejo që zemrat tona të shmangen (nga e vërteta), pasi na ke udhëzuar në rrugën e drejtë, dhe jepna mëshirë prej Teje; vërtet, Ti je Dhuruesi i Madh! (Ali Imran 8)**

Të jesh besimtar, të jesh praktikant, të jesh i qëndrueshëm në fe dhe të qëndrosh larg gjynaheve, nuk është gjë tjetër vetëm se një mirësi e madhe e Allahut të Lartësuar kundrejt robërve të Tij.

Besimtarët duhet të jenë të vetëdijshëm për këto mirësi të mëdha dhe duhet të bëjnë çdo përpjekje të mundshme që kurrsesi mos të largohen nga to. Allahu na bëftë të qëndrueshëm në fe dhe na largoftë nga gjynahet.

Amin!

Leonard Çela

Ndikimi i abdesit në meridianet e energjisë së njeriut



Allahu i madhërishtëm na ka shpallur se çdo gjë e ka krijuar nga uji:

"...Ujin e bëmë bazë të jetës së çdo sendi..."¹

Ujin i përzier me dheun krijoi balta:

"Ai është që ju krijoi nga balta..."²

Dhe nga balta krijoi njeriun:

"Dhe (përkujto) kur Zoti yt engjëjve u tha: "Unë po krijoj njeriun nga balta e tharë, e zezë e me erë..."³

Pastaj Allahu e frymëzoi me shpirtin e Tij:

"E kur ta përsosë atë (në formën e njeriut) dhe t'i japë atij shpirtin që është krijesë Imja..."⁴

Askush prej nesh nuk e ka përjetuar krijimin, por do të përjetojmë vdekjen:

"...Ashtu sikundër e kemi filluar krijimin (tuaj), e rikthejmë..."⁵

1. El - Enbija, 30

2. El - En'amë, 2

3. El - Hixhr, 28

4. El - Hixhr, 29

5. El - Enbija, 104

Pra, njeriu u krijua nga uji dhe toka, dhe urtësia qëndron në atë që njeriu i kthehet burimit të tij.

Kusht për robin është të jetë i pastër kur qëndron para Krijuesit, të marrë abdes, e nëse nuk mundet, mund të marrë tejemum (pastrim simbolik).

Allahu i madhërishtëm thotë:

"O ju që besuat! Kur doni të ngriheni për të falur namazin, lani fytyrat tuaja dhe duart tuaja deri në bërryla; fërkoni kokat tuaja, e këmbët lani deri në dy zogjtë..."⁶

Në gjuhën arabe fjala vudu' (abdes) d.m.th. pastërti, qartësi dhe shkëlqesi.

Abdesi është çelës i xhenetit dhe për këtë i Dërguari i Allahut ka thënë: *"Kush prej jush e plotëson abdesin dhe pas përfundimit thotë: "Dëshmoj që nuk ka zot tjetër pos Allahut dhe se Muhammedi s.a.v.s. është robi dhe i dërguari i Allahut", do t'i hapen tetë dyert e xhenetit për të hyrë në të cilën dëshiron"*⁷

6. El - Maide, 6

7. Ahmedi, Muslimi, Ebu Davudi, Nesaiu

Abdesi është dritë në dynja dhe ahiret. Në këtë botë lë gjurmë në formë drite në fytyrë dhe qetësi në zemër dhe e bën jetën e njeriut oazë të jetës dhe burim i besimit të fuqishëm, ndërsa në botën tjetër kjo dritë do t'ia zbukurojë fytyrën dhe këmbët e besimtarit.

Ai do të jetë shenjë me të cilën Pejgamberi s.a.v.s. në ditën e Gjykimit do t'i njohë besimtarët.

Disa sahabë e pyetën Pejgamberin a.s.: "Si do të njohësh o i Dërguar i Allahut atë i cili vie pas teje nga ummeti yt?" Ai u përgjigj: "A thua njeriu nuk mund të njohë kalin e tij i cili ka shenjë të bardhë në ballë dhe këmbë kur gjendet në mesin e kuajve të zinj?" Sahabët u përgjigjën: "Natyrshisht se mundet." Në këtë Pejgamberi a.s. tha:

*"Kështu besimtarët kur do të vijnë te burimi (haud) do të kenë fytyra dhe këmbë të shndritshme nga gjurmët e abdesit."*⁸

Allahu i madhërishtëm u ndihmon njerëzve që nëpërmes abdesit të pastrohen nga mëkatet dhe ngritën në shkallë më të lartë. Duke falënderuar abdesit ata do të jenë të përgatitur të presin takimin me Allahun e madhërishtëm, siç ka thënë i Dërguari i Allahut: "A do t'ju tregoj me çfarë Allahu fshin mëkatet dhe ngritë?" Thanë: "Po i Dërguar i Allahut." Ai tha:

*"Marrja e abdesit me rregull, hapat e shumtë deri në xhami, pritja e namazit tjetër pas namazit, ky është xhihad i juaj."*⁹

Pejgamberi s.a.v.s. ka thënë: *"Pastërtia është gjysma e besimit."*¹⁰

Ja si Islami ka kujdes për marrjen e abdesit me rregull duke arritur me këtë pastrimin e jashtëm dhe të brendshëm të myslimanit. Vërtetimi më i mirë i kësaj që islami potencon në vazhdimësinë e pastërtisë trupore e shpirtërore është thënia e Pejgamberit s.a.v.s.: *"Kush merr abdes me rregull, kryen namazin e obliguar, do t'i falen mëkatet."*¹¹

Shtrohet pyetja: Ku qëndron fshehtësia e harmonisë në mes njeriut dhe botës?

Kjo është energjia shpirtërore e fesë, e energjisë së balancuar në formën më subtile. Frutat e kësaj energjie qartë paraqiten në trup dhe në shpirtin njeriut, sikur që thotë Ibn Abbasi r.a.: "Vërtetë vepra e mirë jep shkëlqim në fytyrë dhe zemër, rrit nafakën, fuqizon trupin dhe ndikon që tjerët ta duan. Ndërsa vepra e keqe vërtetë shkakton nxirje dhe errësirë në fytyrë dhe zemër, dobëson trupin, zvogëlon nafakën dhe shkakton urrejtjen e njerëzve."

Abdesi vërtetë kthen fuqinë në trupin e njeriut, pastron mëkatet, sepse mëkatet dhe veprat e këqija ndikojnë në gjendjen psikofizike të njeriut, me ç'rast njeriu humb fuqinë. Ilaç për këtë është abdesi. Muslimi në hadithin sahih që e transmeton Amr ibn Abese i cili iu lut Pejgamberit s.a.v.s. duke i thënë:

"I Dërguar i Allahut më trego për abdesin?" Ndërsa Pejgamberi s.a.v.s. i tha: "Secili prej jush i cili merr abdes e me këtë rast pastron gojën dhe hundën, nëpër mjekër së bashku me ujën i bien mëkatet nga fytyra, kur pastron duart deri mbi

*bërryla, nëpër gishtërinj i bien mëkatet nga duart, kur bën mes'h kokën, së bashku me ujën i bien mëkatet nga koka, kur pastron këmbët deri mbi nyje, me ujën nëpër gishtërinjtë e këmbës i bien mëkatet e këmbës, kur ngritët dhe falet dhe falënderon Allahun e madhërishtëm ashtu siç e meriton Ai, dhe ia dorëzon zemrën Allahut, pas kësaj do të jetë i liruar nga mëkatet sikur në ditën kur e ka lindur nëna."*¹²

Sikur njeriu të pastrohej me të gjitha mjetet për pastrim, por nuk do të kryente lëvizjet e parapara me rregullat e abdesit të cilat Krjuesi i Urtë na ka urdhëruar, nuk do ta arrinin energjinë dhe harmoninë e merituar.

Shtrohet pyetja: A thua mëkatet lidhen me dorë, këmbë, fytyrë dhe vesh?

Është fakt që mëkatet lënë gjurmë të mëdha në meridianët nëpër të cilët rrjedh energjia vitale, si dhe në fushën vitale e cila rrethon trupin e njeriut. Në realitet, mëkatet e çrregullojnë fushën elektromagnetike e cila pastaj reflektohet në shëndetin e njeriut.

Njeriu siç dihet paraqet një energji kimike dhe elektromagnetike. Kjo energji kuptohet si energji vitale e cila shndërrit nga trupi ynë dhe quhet prana ose vital force. Sido që ta quajmë, kjo energji paraqet diç që realisht është prezentë.¹³

Abdesi është begati dhe dritë. Allahu i madhërishtëm lavdëron ata që pastrohen:

*"...Allahu i do ata që pendohen dhe ata që pastrohen."*¹⁴

Fryti i kësaj dashurie rrjedh nga fshehtësia e emrit të Allahut el - Hafidh (Ai i Cili vigjilon gjithnjë mbi ne). Në të vërtetë Allahu e ruan njeriun me armën e jashtme dhe të brendshme, e kjo armë është abdesi. A thua edhe kjo nuk është një begati e Allahut të madhërishtëm:

*"...në qoftë se përpiqeni t'i numëroni të mirat e Allahut, nuk do të mund të arrini t'i përkufizoni (në numër)..."*¹⁵

Një abdes mbi tjetrin është sikur se një dritë mbi tjetrën. Për këtë Pejgamberi s.a.v.s. kur nisej për namaz lexonte këtë lutje: *"O Zoti im, më jep dritë në zemër, dritë në sy, dritë në vesh, dritë nga ana e djathtë, dritë nga ana e majtë, dritë mbi mua, dhe dritë nën mua."*¹⁶

Në bazë të kësaj që përmendëm është e qartë që njëra prej begatave të fshehta për besimtarin është abdesi i cili rikthen baraspeshën primare në fushën vitale e cila rrethon njeriun dhe rregullon secilin çrregullim në meridianët nëpër të cilët rrjedh energjia. Përveç pastërtisë fizike, abdesi e mbron njeriun nga gjithë ndikimet negative të teknologjisë bashkëkohore dhe ndotjes së mjedisit e cila ndikon në energjinë vitale të njeriut.

O Allah i madhërishtëm na mundëso që t'i kryejmë obligimet Tuaja ashtu që Ti të jesh i kënaqur!

Prim.dr.med.sc. Ali F. Iljazi

8. Muslimi, Nesaiu, Ibn Maxhxheh

9. Muslimi dhe Tirmidhiu

10. Muslimi

11. Ahmedi dhe Muslimi

12. Muslimi

13. Brecher, Secrets of Energy Work, Darling, Kindrsley

14. El - Bekare, 222

15. Ibrahim, 34

16. Buhariu

Për ty Allahu mjafton...



Ti!

Ti që dje ishe vetëm një plan i bukur për të plotësuar një familje të re.

Ti që dje nuk dije as të lidhje dy fjalë.

Ti që dje shihje çdo gjë me sytë e çiltër të një fëmije të pafajshëm.

Ti që dje ishe i pafuqishëm për të ecur me këmbët e tua.

Ti që dje, me pretekstin se kishe frikë, nuk doje të largoheshe nga përqaftimi i ngrohtë i nënës.

Ti që dje doje të ishe i lirë, i pavarur.

Ti që dje nuk ishe i përgjegjshëm për ato që bëje.

Ti që dje nuk doje t'ia dije nëse lëndoje njeri, nëse thyeje një zemër apo vrisje një shpresë.

Ti që dje gjeje shpëtim në mëkat, largoje problemet me një gotë alkool, gjeje ngushëllim në rrugë të gabuar.

Ti që dje kujtoje se kishe çdo gjë dhe e ndjeje zemrën më bosh se vetë errësira.

Ti që dje kujtoje se bota ishte jotja, por vetminë e kishe shoqëruese të shpirtit tënd të ngratë.

Ti që dje kënaqeshe kur dikush derdhte lot, vuante...

Ti që dje nuk pranoje fajin dhe gabimin nuk e quaje pjesë tënden.

Ti që dje nuk prekeshe as nga e qara e një foshnjeje që kërkonte nënën e vet.

Ti që dje përbuzje edhe njeriun e shkretë, që nga nevoja shtrinte dorën para çdo njeriu për të kërkuar lëmoshë për fëmijët e tij.

Ti që dje braktise nënë e baba.

Ti që bëre shtëpi tënden çdo vend jo të hijshëm.

Ti që dje udhëhiqeshe nga egoja jote, ishe bërë rob i saj.

Ti që dje mendoje për vete ...

Ti...

Ti që sot pendohesh për çdo sekondë të shkuar dëm.

Ti që sot gjete Zotin Tënd.

Ti që sot u ftove në shpëtim.

Ti që sot u ftove në namaz.

Ti që sot përulesh para Zotit Tënd.

Ti që sot ecën në rrugë të drejtë.

Ti që sot shndrit në fytyrë si një yll në tokë.

Ti që sot dridhesh vetëm duke dëgjuar emrin e Tij të përmendet.

Ti që sot vrapon për në shtëpinë që gjithnjë ka qenë e jotja, për në xhami.

Ti që sot gjen ngushëllim te namazi yt, te sexhdja jote, te Kur`ani Famëlartë.

Ti që sot afrohesh çdo ditë me Zotin tënd me anë të lutjeve të tua.

Ti që sot bën çdo gjë që Atij i pëlqen.

Ti që sot i rri larg çdo gjëje që Ai nuk e quan të pëlqyeshme.

Ti që sot mundohesh të ecësh në hapat e Profetit tënd të dashur (s.a.s).

Ti që sot puth çdo pjesë toke ku nëna jote shkel.

Ti që sot ha veten me dhëmbë për një namaz të vonuar.

Ti që sot nuk ia fal vetes qoftë dhe një lot te derdhur nga syri i asaj që të dha jetë.

Ti që sot prekeshe nga një zog i vogël që nuk ngrihet dot në fluturim.

Ti që sot ke dhembshuri për çdo gjë që sheh.

Ti që sot falënderon Atë për çdo mirësi.

Ti që sot u bekove me një foshnje që ta ka bërë zemrën më të butë se mëndafshi.

Ti që sot nuk pret asgjë në këmbim, por mjaftohesh me një buzëqeshje.

Ti që sot bën çdo gjë për hir të Allahut tënd (xh.xh).

Ti që sot do të ndryshosh botën.

Ti që sot arrin të shohësh mrekullitë që të rrethojnë.

Ti që sot mësove ç'është thotë të falësh.

Ti që sot mësove të japësh mundësi të dyta.

Ti që sot e ke zemrën plot.

Ti që sot nuk ndjehesh asnjëherë vetëm.

Ti që sot vlerëson çdo sekondë.

Ti që sot lufton për një të nesërme më të mirë.

Ti që sot punon për një jetë të pastajme.

Ti që sot fle me emrin e Allahut dhe çohesh me falënderimin ndaj Tij.

Ti që nesër do të jesh një shembull.

Ti që nesër do të shpëtosh edhe të tjerë.

Ti që nesër do t'i quash të gjithë motra e vëllezër.

Sot është dita, nesër mund të jetë shumë vonë.

Duaj, Fal, Dhuro, Bindu, Sakrifiko, Shpjego!

Për ty Allahu mjafton...

ARJOLA ZAÇI – Medreseja e Korçës



RAMAZAN

2024 - 1445 H.

MIRË SE VJEN **O MUAJ I BEKUAR**

Ramazan	Ditët	Mars Prill	*Agimi (Imsaku)	Lindja e Diellit	Dreka (Yleja)	Pasditja (Iqindia)	Perëndimi (Akshami)	Darka (Jacia)
1	H.	11	04:23	05:55	11:58	15:12	17:49	19:10
2	M.	12	04:21	05:53	11:58	15:12	17:50	19:11
3	M.	13	04:20	05:52	11:57	15:13	17:51	19:12
4	E.	14	04:18	05:50	11:57	15:14	17:52	19:14
5	P.	15	04:16	05:48	11:57	15:14	17:53	19:15
6	SH.	16	04:14	05:47	11:57	15:15	17:54	19:16
7	D.	17	04:12	05:45	11:56	15:15	17:55	19:17
8	H.	18	04:11	05:43	11:56	15:16	17:56	19:18
9	M.	19	04:09	05:42	11:56	15:17	17:58	19:20
10	M.	20	04:07	05:40	11:55	15:17	17:59	19:21
11	E.	21	04:05	05:38	11:55	15:18	18:00	19:22
12	P.	22	04:03	05:37	11:55	15:18	18:01	19:23
13	SH.	23	04:02	05:35	11:54	15:19	18:02	19:24
14	D.	24	04:00	05:33	11:54	15:19	18:03	19:26
15	H.	25	03:58	05:31	11:54	15:20	18:04	19:27
16	M.	26	03:56	05:30	11:54	15:20	18:05	19:28
17	M.	27	03:54	05:28	11:53	15:21	18:06	19:29
18	E.	28	03:52	05:26	11:53	15:21	18:07	19:31
19	P.	29	03:50	05:25	11:53	15:22	18:08	19:32
20	SH.	30	03:48	05:23	11:52	15:22	18:09	19:33
21	D.	31	04:47	06:21	12:52	16:23	19:11	20:34
22	H.	1	04:45	06:20	12:52	16:23	19:12	20:36
23	M.	2	04:43	06:18	12:51	16:24	19:13	20:37
24	M.	3	04:41	06:16	12:51	16:24	19:14	20:38
25	E.	4	04:39	06:15	12:51	16:24	19:15	20:40
26	P.	5	04:37	06:13	12:51	16:25	19:16	20:41
27	SH.	6	04:35	06:11	12:50	16:25	19:17	20:42
28	D.	7	04:33	06:10	12:50	16:26	19:18	20:44
29	H.	8	04:31	06:08	12:50	16:26	19:19	20:45
30	M.	9	04:29	06:06	12:49	16:26	19:20	20:46



Oraret i referohen Tiranës

Për zonat e tjera si vijon: Durrës +2', Shkodër +2', Vlorë +1', Lushnjë +1', Berat 0', Elbasan -1', Kukës -1', Peshkopi -2', Librazhd -2', Korçë -5'.

05.04.2024

(e premte) **Nata e Kadrit.**

10.04.2024 (e mërkurë)

Dita e parë e **Fitër Bajramit.**

Bajrami falet në orën 06:55.

31.03.2024 (e diel) - Pritet të bëhet ndryshimi i orës 60' para.

*Limiti i lejimit të ngrënies dhe pirjes para fillimit të agjërimit.

1 Koha e agjërimit është nga agimi deri në perëndimin e diellit, sipas orarit ditor.

2 Agjërimi priset nëse ha ose pi me qëllim, vjelli me qëllim, kryen marrëdhënie intime, përryp çamçakëz ose pi duhan.

3 Gruas me perioda ose lehonë i ndalohet të agjërojë, por këto ditë duhet t'i plotësojë më vonë, pas Ramazanit.

4 Gratë shtatzëna, gruaja me fëmijë në gjii, i sëmurë dhe udhëtari lejohen të mos agjërojnë, por duhet t'i plotësojnë më vonë ditët e lëna.

5 Të moshuarit dhe të sëmurët kronikë, që nuk mund të agjërojnë dhe as mund t'i plotësojnë ditët që nuk kanë agjëruar, për çdo ditë të Ramazanit ushqejnë një të varfër a nevojtar.